



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Brendshme
Zëvendësministri
Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit në Njerëz

RAPORT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE
PËR LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË QENIEVE
NJERËZORE

JANAR – DHJETOR 2010

TIRANË, SHKURT 2011

FALËNDERIME

Për këtë material punuan:

Zj. Irena TAGA, Drejtor i Njesisë Antitrafik

Zj. Ana JANKU, Koordinatore në Njësinë Antitrafik

Zj. Vilma ÇOBANI, Koordinatore në Njësinë Antitrafik

Z. Milaim DEMNUSHAJ, Koordinator në Njësinë Antitrafik

Realizimi i këtij raporti nuk do të ishte i mundur pa informacionin e nevojshëm të siguruar nga institucionet zbatuese të Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore si: Ministria e Brendshme; Policia e Shtetit; Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta; Ministria e Arsimit dhe Shkencës; Ministria e Punëve të Jashtme; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Financave; Ministria e Mbrojtjes; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve; Prokuroria e Përgjithshme; Prokuroria për Krimet e Rënda; Gjykata për Krimet e Rënda, Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda; Organizatat Ndërkombëtare dhe OJF-të vendase, Qendrat pritëse dhe ri-integruese për viktimat e trafikimit, Komitetet Rajonale Antitrafik si dhe të gjithë partnerët dhe aktorët e tjerë që kanë dhënë kontributin e tyre në zbatimin e Strategjisë Antitrafik 2008-2010.

Gjithashtu, një falënderim i veçantë është për Koordinatorin Kombëtar për Çështjet e Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Zëvendësministren e Brendshme, Zj. Iva ZAJMI, pa mbështetjen e vazhdueshme të së cilës ky material nuk do të ishte në formën aktuale.

Një falënderim tjetër shkon për UNODC - Tiranë, e cila ka mbështetur financiarisht këtë botim.



Përkthimi dhe botimi i këtij Raporti Vjetor u mundësuan nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin përmes kontributit bujar të qeverisë italiane.

PASQYRA E LËNDËS

Ndjekja Penale	5
a. Plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor	5
b. Kompensimi i viktimave të trafikimit	6
c. Rritja dhe ngritja e kapaciteteve të zbatimit të ligjit	7
ç. Lufta kundër përfshirjes së strukturave të zbatimit të ligjit në veprat penale të trafikimit në njerëz	8
d. Bashkëpunimi brenda dhe jashtë vendit	9
dh. Të dhëna statistikore në lidhje me hetimin dhe gjykimin	11
e. Gjetje dhe rekomandime	14
Mbrojta dhe Asistenca ndaj Viktimave të Trafikimit	15
1. Plotësimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen dhe asistencën e viktimave të trafikimit	15
2. Garantimi i shërbimeve të asistencës ndaj viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit	16
2.a Aktiviteti i qendrave	17
a. Informacion:	17
b. Siguri dhe mbrojtje:	18
c. Përkujdesje:	18
d. Rehabilitim:	19
e. Ri-integrim:	20
f. Monitorimi dhe ndjekja e rasteve	21
g. Përkujdesje për fëmijët e viktimave të trafikimit:	21
3. Mekanizmi Kombëtar i Referimit (MKR) dhe Baza e të Dhënave për viktimat e trafikimit	22
4. Identifikimi dhe referimi i viktimave të trafikimit	23
a. Rritja e kapaciteteve për aktorët që kryejnë identifikimin fillestar dhe formal të një viktime trafikimi	23
b. Rritja e kapaciteteve për aktorët që mund të kryejnë identifikimin fillestar të një viktime trafikimi	24
4.1 Identifikimi brenda territorit të vendit	24
4.2 Identifikimi në kufi	24
4.3 Identifikimi jashtë vendit	26
5. Mbrojta e viktimave dëshmitare	26
REKOMANDIME:	27
Parandalimi	27
1. Plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor	28
2. Rritja e ndërgjegjësimit publik	29
2.1. Fushata ndërgjegjësuese	29
2.2. Trajnime me median	31

3. Përmirësimi i kapaciteteve të aktorëve që punojnë me kategoritë vulnerabël	31
4. Punësimi	32
4.1. Programet aktive të tregut të punës/ Programet e nxitjes së Punësimit	32
4.2. Formimi Profesional (grupet e veçanta)	33
5. Arsimi	34
5.1. Vazhdimi i përpjekjeve për rritjen e pjesëmarrjes në arsimin e detyrueshëm/uljen e braktisjes shkollore	34
5.2. Arsimimi i pakicave etnike	35
5.3. Arsimi i fëmijëve të ngujuar	35
5.4. Ndërgjegjësimi i fëmijëve në sistemin shkollor	35
5.5. Institucionalizimi i një sistemi të “mbrojtësve të fëmijëve” në shkolla	36
6. Institucionalizimi i mekanizmave të mbrojtjes parandaluese dhe përkrahjes në nivel vendor dhe rajonal për grupet në nevojë dhe në rrezik trafikimi si dhe identifikimi dhe sigurimi i masave parandaluese për individët në nevojë.	37
6.1. Aktiviteti i Komiteteve Rajonale Antitrafik	37
7. Të tjera	38
7.1. Në Fushën e Mbrojtjes së Fëmijëve nga Shfrytëzimi për Punë	38
7.2. Promovimi i Kodit të Sjelljes në Turizëm	39
7.3. Trajtimi i çështjeve që qëndrojnë në themel të trafikimit (përfshi varfërinë dhe papunësinë, diskriminimin e grave, pakicave, fëmijëve, migrantëve dhe grupet e tjera në nevojë)	40
8. Rekomandime	40

ANEKS I – Trajnimet e zhvilluara me Policinë, Prokurorinë dhe Gjykatat me objekt Trafikimin e Qenieve Njerëzore **41**

Aneks II – Tabela me të dhëna për vitin 2010 për çështjet me objekt TQNJ të gjykuara nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda **43**

Aneks III – Tabela me të dhëna për vitin 2010 për çështjet me objekt TQNJ të gjykuara nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda **44**

ANEKS IV – Fëmijë të dëmtuar nga krime dhe veprimtari të tjera të paligjshme gjatë vitit 2010 **45**

Në vijim të këtij kapitulli do të gjeni të pasqyruar çështje të rëndësishme në lidhje me një ndër shtyllat më kyçe të luftës kundër trafikimit në njerëz të tilla si: ndryshimet në kuadrin ligjor, rritje dhe ngritje kapacitetesh, statistika në lidhje me evidentimin, hetimin dhe gjykimin e veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore etj.

a. Plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor

Gjatë vitit 2010, në zbatim dhe të drejtimeve kryesore të Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008-2010, ndryshimet thelbësore të kuadrit ligjor janë si më poshtë:

1. Miratimi i Ligjit Nr. 10220, datë 04.02.2010 *“Për Shpalljen e Moratoriumit për Mjetet Motorike Lundruese të Republikës së Shqipërisë”*, me qëllim vazhdimin e luftës kundër trafikeve të paligjshme, duke u bazuar në efektet pozitive që ka patur zbatimi i moratoriumit të mëparshëm;
2. Miratimi i Ligjit nr. 10301, datë 15.07.2010 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8677, datë 02.11.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë Gjyqësore” të ndryshuar”*. Ky ligj rregullon marrëdhëniet ndërmjet prokurorisë dhe policisë gjyqësore me qëllim rritjen e efektivitetit në dhënien e drejtësisë penale. Gjithashtu, ligji i ri synon të përmirësojë performancën e Policisë Gjyqësore, duke rritur efektivitetin në parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale, duke ndikuar drejtpërdrejt në luftën kundër kriminalitetit, nëpërmjet ndarjes dhe qartësimin të kompetencave dhe detyrave midis agjencive, si në nivel qendror dhe vendor si dhe nxitjes së bashkëpunimit midis tyre.
3. Në zbatim të ligjit Nr. 10192, datë 3.12.2009 *“Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”*, është miratuar:
 - VKM Nr. 314, datë 5.05.2010 *“Për Organizimin, Kompetencat dhe Funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara (AAPSK), dhe për përcaktimin e shpërblimit të personave të tretë, në administrimin e pasurisë”*, i cili përcakton rregulla të detajuara për organizimin dhe funksionimin e kësaj Agjencie;
 - VKM Nr. 563, dt. 14.07.2010 *“Për Përcaktimin e Rregullave dhe të Procedurave të Hollësishme të Bashkëpunimit të Shërbimit Përmbarimor me AAPSK, si dhe Pagesën Përkatëse për Shërbimin e Përmbarimit”*;
 - VKM Nr. 623, dt. 23.07.2010, *“Për Kriteret e Vlerësimit, Mënyrat dhe Procedurat e Dhënies në Përdorim dhe të Tjetërsimit të Pasurive të Konfiskuara në Zbatim të Ligjit Nr. 10192”*;
 - VKM Nr. 666, dt. 04.08.2010 *“Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 314, dt. 05.05.2010 të Këshillit të Ministrave “Për Organizimin, Kompetencat dhe Funksionimin e AAPSK dhe për Përcaktimin e Shpërblimit, të Personave të Tretë, në Administrimin e Pasurisë”*. Këto ndryshime plotësojnë vakuumin ligjor duke rritur operativitetin dhe efikasitetin e AAPSK për administrim dhe përdorimin e pasurive dhe asetëve të sekuestruara/konfiskuara me vendim të gjykatës, përfshirë edhe ato asete dhe pasuri të përfuara nga veprimtari kriminale të lidhura me trafikimin e qenieve njerëzore. Këto të fundit mund të shërbejnë edhe si burim i drejtpërdrejtë për financimin e aktiviteteve dhe veprimtarive antitrafikim, në veçanti për mbrojtjen e viktimave të trafikimit.
4. Në zbatim të ligjit nr. 10193 dt. 03.12.2009 *“Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale”*, janë miratuar nga Ministri i Drejtësisë:
 - Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm (nënshkruar nga Ministri i Drejtësisë Nr. 3273/1 datë 28.04.2010 dhe nga Prokurori i Përgjithshëm Nr. 5 datë 21.07.2010) *“Për Përcaktimin e Rregullave mbi Formën e Letër-kërkesës, Procedurën dhe Përkthimin e Akteve”*, i cili përcakton rregullat dhe procedurat që duhet të zbatohen nga prokuroria, gjykata dhe organet e tjera të përfshira në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në veprimtarinë e tyre administrative në kuadër të transmetimit të letër-kërkesave;
 - Udhëzimi i Ministrit të Drejtësisë nr. 3922 datë 28.04.2010 *“Mbi Mënyrën dhe Procedurën e Regjistrimit të Dënimeve të Dhëna ndaj Shtetasve Shqiptarë nga Autoritetet Gjyqësore të*

Huaja”, i cili parashikon krijimin nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore të një regjistri të posaçëm, shkresor dhe elektronik, për regjistrimin e vendimeve penale të autoriteteve të huaja, të dhëna ndaj shtetasve shqiptarë.;

- VKM Nr. 924, datë 17.11.2010 për miratimin e projektligjit “Për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Belgjikës për Transferimin e Personave të Dënuar”, me qëllim shqyrtimin dhe miratimin e tij, në Kuvend. Ky projektligj është shqyrtuar dhe miratuar nga tre komisione parlamentare (Komisioni i Sigurisë, Komisioni i Jashtëm dhe Komisioni i Ligjeve) dhe së shpejti, do të miratohet në seancë plenare;
5. Me VKM Nr. 884, datë 08.11.2010, është miratuar në parim *Protokolli i Tretë Shtesë i Konventës Europiane “Për ekstradimin”*, e cila parashikon rregulla të detajuara mbi realizimin e procedurës së ekstradimit të thjeshtuar. Kjo Konventë është nënshkruar, nga përfaqësuesi i Republikës së Shqipërisë, pranë Këshillit të Europës, në Strasburg, më datë 10 nëntor 2010;
 6. Gjithashtu, më datë 29 Korrik 2010 është nënshkruar në Belgjikë, Protokolli i bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë dhe Departamentit Federal të Drejtësisë së Mbretërisë së Belgjikës, i cili synon forcimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit administrativ në fushën e drejtësisë;
 7. Miratimi i udhëzimit nr. 30, datë 05.02.2010 i Ministrit të Brendshëm “Për Veprimin e Përbashkët të Strukturave Zbatuese të Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore”;
 8. Miratimi i Urdhrit nr. 69 datë 25.01.2010 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për Koordinimin e Punës ndërmjet Strukturave Qendrore dhe Vendore për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore e Identifikimin e Viktimave të Trafikimit”.

b. Kompensimi i viktimave të trafikimit

Një punë e mirë është bërë edhe në drejtim të **kompensimit të viktimave të trafikimit**. Në fillim të vitit 2010, nga Gjykata e Shkallës I-rë Tiranë është marrë një vendim (Nr. 1202 dt. 19.02.2010), sipas të cilit, viktimës së trafikimit i njihet **e drejta e kompensimit** në një vlerë të konsiderueshme, e cila do të shlyhet nga autori i veprës penale. Ky vendim, i pari i këtij lloji, shënon një hap pozitiv në drejtim të krijimit të një praktike për kompensimin e viktimave të trafikimit.

Në zbatim Ligjit Nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” janë miratuar aktet nënligjore¹, si dhe është ngritur **Komiteti Këshillimor Ndërinstitucional i Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar**. Sipas ligjit, ky komitet është përgjegjës për mbikëqyrjen e administrimit të pasurive të konfiskuara nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe për marrjen e vendimeve për destinacionin e tyre. Komiteti ka miratuar Rregulloren e Funkcionimit të tij, është mbledhur rregullisht si dhe ka marrë vendime duke i rekomanduar Ministrit të Financave mbi mënyrën e përdorimit të pasurive të konfiskuara. Së fundi, Komiteti ka vendosur edhe për **ngritjen e fondit të posaçëm për parandalimin e kriminalitetit dhe edukimin ligjor**, fond i cili do të mund të përdoret dhe do të jetë një burim i rëndësishëm për mbrojtjen dhe për kompensimin e viktimave të trafikimit. Ngritja dhe miradministrimi i këtij fondi është edhe kërkesë e organizmave të rëndësishme ndërkombëtarë siç është edhe rekomandimi i Raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit (TIP – Report 2009). Gjatë vitit 2010, një punë e mirë është bërë edhe për rritjen e operativitetit dhe efijencës së **Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK)**, e cila ka nën administrim të gjitha pasuritë e sekuestruara / konfiskuara me vendim të gjykatës, përfshirë edhe ato asete dhe pasuri të përfutuara nga veprimtari kriminale të lidhura me trafikimin e qenieve njerëzore. Numri total i stafit të Agjencisë aktualisht është 24 (punonjës të AAPSK, administratorë të jashtëm). Aktualisht AAPSK ka në administrim në total **pasuri të sekuestruara në vlerën 760.997.943 lekë** (5.435.699 Euro ose 7.609.979 \$).

¹ Për më shumë informacion shih në kapitullin NDJEKJA PENALE - pika a. Përmirësimi i Kuadrit Ligjor

c. Rritja dhe ngritja e kapaciteteve të zbatimit të ligjit

Viti 2010 ka sjellë një ndryshim të rëndësishëm për sa i përket rritjes së kapaciteteve në burime njerëzore të forcave të zbatimit të ligjit. Më konkretisht:

1. Me Urdhrin nr. 372/6 të datës 26.01.2010 të Ministrit të Brendshëm “Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 372 datë 08.06.2009” “Për Miratimin e Strukturës dhe Limitit të Organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit” dhe Nr. 200 datë 17.06.2010 **janë rritur kapacitetet** e Sektorit kundër Trafikeve të Paligjshme (SKTP) me **18 funksione të reja**; 3 në qendër dhe 15 në bazë, kryesisht në drejtim të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore (në DPQ Durrës, Shkodër, Lezhë, Vlorë, Korçë, Kukës, Dibër dhe Gjirokastrë). Tashmë, PSH në SKTP ka 88 funksione nga 70 në fund të vitit 2009, pra **20.4% më shumë se viti i kaluar**. Nga 88 punonjës që ka SKTP 40 punonjës ose 45% e tyre mbulojnë drejtimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore.
2. Në Institucionin e **Prokurorisë së Krimeve të Rënda**, që funksionon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në mbështetje të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bazuar në urdhrin nr. 259, datë 24.03.2010 të Drejtuesit të Prokurorisë, është ngritur seksioni për hetimin e çështjeve që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, në përbërje të të cilit janë 2 prokurorë me eksperiencë pune disa vjeçare në hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të çështjeve që kanë të bëjnë me trafikimin e qenieve njerëzore (nenet 110/a, 114/b dhe 128/b). Ngritja e këtij seksioni, si dhe profilizimi i punës së dy prokurorëve ka ndikuar në rritjen e bashkëpunimit dhe ka lehtësuar procesin e komunikimit me sektorin e policë antitrafik (OPGJ-të dhe Drejtorinë e Policisë në Qarqe), duke rritur kështu cilësinë e hetimit dhe duke dhënë në kohë konsultimin e duhur ligjor lidhur me rastet e trafikimit të qenieve njerëzore. Gjithashtu, në bazë të urdhrit nr. 723/1, datë 30.09.2010, është caktuar një Oficer e Policisë Gjyqësore pranë kësaj Prokurorie e ngarkuar me mbajtjen e kontakteve të vazhdueshme me viktimat e trafikimit në çdo fazë të hetimit apo gjykimit të çështjes me qëllim krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për viktimat e trafikimit. Nëpërmjet këtij funksioni ofrohet ndihmë psikologjike apo çdo lloj ndihme tjetër që mund të sigurohet nga ana e prokurorisë, si dhe lehtësohet komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave ndërmjet prokurorisë dhe qendrave.

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2010 nga ana e Policisë, në bashkëpunim me ZKKA, Prokurorinë, Gjykatat, Ministrinë e Drejtësisë, Shkollën e Magjistraturës dhe shoqërinë civile (OJF dhe ON) janë zhvilluar disa trajnime², të cilat duke marrë në konsideratë dhe rezultatet e arritura nga forcat e zbatimit të ligjit, mund të themi me bindje se kanë qenë tepër të vlefshme. Gjatë vitit 2010, janë zhvilluar **16 trajnime** në të cilët janë **trajnuar 259 specialistë**, kryesisht të Sektorit kundër Trafikeve të Paligjshme, por edhe nga struktura të tjera të Policisë së Shtetit si: Sektori i Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Dhunës në Familje; Policia e Kufirit dhe Migracionit si dhe nga Struktura të Parandalimit të Krimit dhe Policimit në Komunitetet. Gjithashtu, në bashkëpunim me **ZKKA**, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Prokurorinë e Përgjithshme, Ministrinë e Drejtësisë, Shkollën e Magjistraturës dhe shoqërinë civile (OJF dhe Organizata Ndërkombëtare) janë organizuar **disa trajnime dhe seminare të përbashkëta** me pjesëmarrjen e punonjësve të policisë, punonjësve të shërbimit social shtetëror, gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve, studentëve të magjistraturës dhe aktorë të tjerë të përfshirë në parandalimin dhe luftën kundër trafikimit në njerëz.

1. Në kuadër të njohjes dhe zbatimit të ligjit Nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, si dhe ligjit Nr. 10193, datë 3.12.2009 “Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale”, Shkolla e Magjistraturës (SHM) dhe Ministria e Drejtësisë (MD) kanë realizuar **disa trajnime**³. Në këto trajnime kanë marrë pjesë gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe studentë të Shkollës së Magjistraturës;

2 Për informacion më të detajuar lidhur me trajnimet e zhvilluara gjatë vitit 2010 shiko në fund të raportit – Aneks I

3 Për informacion më të detajuar lidhur me datat dhe temat e trajnimeve shiko në fund të raportit – Aneks I.

2. Në zbatim të ligjit nr. 10193 datë 3.12.2009 “*Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale*”, i cili përcakton rregullat plotësuese procedurale në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale, në datat 11 – 12 tetor 2010 është zhvilluar seminari me temë “*Legjislacioni Penal Europian*”, asistuar nga TAIEX, në të cilin morën pjesë gjyqtarë, prokurorë, ekspertë të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, avokatë dhe studentë të Shkollës së Magjistraturës. Seminari kishte në fokus të tij trajtimin e problemeve të hasura në praktikë nga gjyqtarët mbi zbatimin e disa neneve të ligjit, si dhe mbi përkthimin e letërporosive;
3. Në kuadër të **Programit Fillestar** për studentët e vitit të dytë të Shkollës së Magjistraturës (14 kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë), gjatë periudhës shkurt –qershor 2010 është **zhvilluar lënda që trajton tema të veçanta lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore**. Në total janë zhvilluar 16 orë mësimore me tematika të ndryshme si:
 - Trafikimi i qenieve njerëzore konteksti social;
 - Analiza e faktorëve që favorizojnë trafikimin e qenieve njerëzore;
 - Stresi, stresi post-traumatik, trauma, konsumimi profesional dhe mekanizmi mbrojtës;
 - Komunikimi me viktimën, procesi i komunikimit. Gjuha verbale dhe jo verbale;
 - Ndërtimi i marrëdhënieve bazuar mbi besimin;
 - Pasojat tek viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Riintegrimi;
 - Trafikimi i qenieve njerëzore – si fenomen kompleks, shkaqet e trafikimit;
 - Sistemi i drejtësisë - Legjislacioni ndërkombëtar dhe vendas, metodat e hetimit dhe aspekte të tjera që kanë të bëjnë me gjykimin.
4. Gjatë muajit nëntor – dhjetor në disa qarqe të vendit (Lezhë, Elbasan, Kukës dhe Gjirokastrë) **ZKKA** në bashkëpunim me **IOM** ka zhvilluar **4 takime të përbashkëta për pilotimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave të Trafikimit**. Në këto takime kanë marrë pjesë specialistë të policisë antitrafik, policisë së kufirit, si dhe punonjës të zyrave rajonale të shërbimit social shtetëror në total **71 persona**;
5. Në bashkëpunim me OSBE, gjatë 6-mujorit të parë të 2010 janë zhvilluar disa seminare me temë “**Mbi të Drejtat e Fëmijëve**”. Seminaret janë zhvilluar në Drejtoritë e Policisë së Qarqeve Shkodër, Gjirokastrë, Dibër, Vlorë, Kukës dhe në secilin prej tyre kanë marrë pjesë **20-25 punonjës** të strukturave të parandalimit të krimit dhe policimit në komunitet;
6. Gjatë muajit dhjetor 2010, në bashkëpunim me “Terre des Hommes” dhe ZKKA, janë organizuar **dy Workshop-e** të fokusuar në çështje që kanë të bëjnë me “Identifikimin dhe trajtimin e fëmijëve të abuzuar dhe keqtrajtuar, fëmijëve viktimë të dhunës në familje, njohje me legjislacionin përkatës”. Në këto aktivitete kanë marrë pjesë **20 - 25 specialistë** (për secilin aktivitet) nga Sektori për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunën në Familje si dhe përfaqësues të Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve.

ç. Lufta kundër përfshirjes së strukturave të zbatimit të ligjit në veprat penale të trafikimit në njerëz

Nga të gjitha informacionet e mbledhura, për vitin 2010 nuk rezulton të ketë raste të përfshirjes së strukturave të policisë dhe të organeve të tjera të drejtësisë në vepra penale të trafikimit të qenieve njerëzore.

Gjatë kësaj periudhe, pranë strukturave të **Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm (SHKB)**, janë administruar 308 ankesa me shkrim dhe janë paraqitur për ankesë me gojë 387 shtetas. Ankesat kanë patur natyrë administrative, por në asnjë rast shtetasit nuk kanë denoncuar për implikim të oficerëve të policisë në trafikimin e qenieve njerëzore.

Edhe nga ana e **Shërbimit Informativ Shtetëror (SHISH)**, gjatë vitit 2010, nuk janë konstatuar raste të implikimit të strukturave të policisë apo zyrtarëve të tjerë në veprimtari të trafikimit të qenieve njerëzore. Nga ana e këtij institucioni janë përcjellë informacione të vlefshme lidhur me veprimtari konkrete të disa rrjeteve të organizimit të emigracionit të paligjshëm, përfshirë edhe të dhëna për përfshirje të punonjësve të policisë së shtetit, të cilët kanë favorizuar emigracionin e

paligjshëm. Gjatë kësaj periudhe, SHISH ka iniciuar 6 bashkëpunime operacionale me strukturat e Policisë së Shtetit për parandalimin dhe ndërprerjen e veprimtarive që lidhen me favorizimin e emigracionit të paligjshëm, si dhe ka dërguar 7 informacione të tjera (5 me objekt trafikimin e qenieve njerëzore dhe 2 për organizim të emigracionit të paligjshëm) drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme dhe Policisë së Shtetit.

d. Bashkëpunimi brenda dhe jashtë vendit

Ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatet e arritura në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore ka patur edhe bashkëpunimi i strukturave të policisë antitrafik me strukturat e tjera të Policisë së Shtetit si Policia Kufitare dhe Migracionit, Strukturat e Parandalimit të Krimeve etj. Produkt i bashkëpunimit me Departamentin e Sigurisë Publike ka qenë dhe hartimi i Planit të Veprimit 2011-2013 “Për Implementimin e Policimit në Komunitet”, me qëllim përmirësimin e punës dhe rritjen e bashkëpunimit midis strukturave të Policisë së Shtetit.

Gjatë vitit 2010, është përmirësuar ndjeshëm edhe bashkëpunimi me partnerët e tjerë në veçanti me Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Gjatë këtij viti janë ngritur dhe funksionojnë disa grupe pune dhe tryeza të përbashkëta, pjesë aktive e të cilave është edhe shoqëria civile. Këtu mund të përmendim:

- Takimet e përmuajshme të zhvilluara në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Në zbatim të Urdhrit nr. 69 datë 25.01.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për Koordinimin e Punës ndërmjet Strukturave Qendrore dhe Vendore për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Identifikimin e Viktimave të Trafikimit” janë organizuar takime periodike në fund të çdo muaji, ku është diskutuar dhe analizuar situata e trafikimit të qenieve njerëzore në të gjithë vendin. Pjesëmarrës të përhershëm në këto takime janë Zyra e Koordinatorit Kombëtar, si edhe përfaqësues të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Qendrave Pritëse dhe Riintegruese të viktimave të trafikimit, si dhe të ftuar të tjerë;
- Takimet me qendrat dhe OJF-të për të lehtësuar koordinimin e tyre me institucionet dhe strukturat shtetërore në nivel qendror dhe vendor, me qëllim sigurimin e një mbrojtjeje efektive ndaj viktimave të trafikimit;
- 2 grupet e punës⁴ për të kryer vlerësimin e legjisllacionit lidhur me zbatimin e *Konventës së Këshillit të Evropës “Për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore”* dhe ngritjen e një sistemi monitorimi dhe mbrojtjeje për fëmijët e shfrytëzuar.

Për sa i përket **bashkëpunimit ndërkombëtar**, nga ana e Policisë së Shtetit po shkëmbehen informacione dhe kryhen hetime të përbashkëta me:

- Autoritetet policore belge në lidhje me veprimtarinë e një grupi të organizuar kriminal shqiptar që e ushtron veprimtarinë e tij në Belgjikë.
- Po bashkëpunohet edhe me autoritetet policore britanike nëpërmjet zyrës së kontaktit për SOCA-n “Special Organized Crime Agency” në lidhje me hetimin që po zhvillohet ndaj një grupi kriminal shqiptarësh të krimit të organizuar, që mendohet se janë të përfshirë në trafikimin e heroinës dhe kokainës, si dhe në trafikimin e femrave për qëllime prostitucioni në Britaninë e Madhe.

Me qëllim rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe për të ndihmuar në shkëmbimin e informacionit me vendet e tjera, janë vendosur **12 oficerë kontakti** (ndërlidhës). Aktualisht, ka oficerë kontakti në Britaninë e Madhe (1 person në Londër); Itali (2 persona në Romë); Greqi (1 person në Athinë dhe 1 në Selanik); Kosovë (1 person në Prishtinë); Turqi (1 person në Stamboll); Belgjikë (1 person në Bruksel); Rumani (1 person në Bukuresht – Qendra SECI); Holandë (1 person në Hagë – Europol); Francë (1 person në Lion – INTERPOL) dhe në SHBA (1 person⁵).

4 Më shumë informacion për dy grupet e punës do të gjeni tek Kapitulli II - MBROJTJA

5 Funksioni i oficerit të ndërlidhjes në SHBA për momentin është vakant

Gjithashtu, disa vende kanë oficerët e tyre të ndërlidhjes të cilët bashkëpunojnë për çështje të ndryshme përfshirë edhe shkëmbimin e informacionit për çështje të trafikimit të qenieve njerëzore midis vendeve të tyre dhe strukturave shqiptare të zbatimit të ligjit. Aktualisht kanë oficerë ndërlidhës të atashuar pranë përfaqësive të tyre diplomatike këto vende: SHBA, Greqi, Danimarkë, Belgjikë, Austri, Francë, Gjermani, Britani e Madhe dhe Itali - INTERFORCA.

Si rregull, për grumbullimin e provave për veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore, procedohet me kërkesë për ndihmë juridike. Ky është mjeti më i zakonshëm, por kohët e fundit institucioni i Prokurorisë po aplikon edhe forma më të shpejta, përfshirë edhe shkëmbimin e informacionit “online” dhe mbi bazën e këtij materiali dërgohet më pas kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale (*letërporosia*) e cila ndjek rrugën standarde, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe kanaleve diplomatike. Bazuar në parimet e reciprocitetit, për të mundësuar një veprim sa më të shpejtë të drejtësisë, veç procedurës standarde të shkëmbimit të informacionit pas paraqitjes së kërkesës në Ministrinë e Drejtësisë, shkëmbimi i informacionit realizohet edhe në mënyrë spontane me një kërkesë drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, e cila, në bashkëveprim me Zyrën e Ndërlidhjes në Ambasadën e vendit të huaj të atashuar në Shqipëri mundëson shkëmbimin e të dhënave të kërkuara, të cilat mund të shërbejnë për fillimin ose përfundimin e hetimit apo procesit gjyqësor.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2010, Prokuroria për Krimet e Rënda ka bashkëpunuar **me disa vende për hetimin e veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore për 13 procedime penale** kryesisht për veprën penale të trafikimit të femrave – neni 114/b i Kodit Penal. Sipas vendeve me të cilët është bashkëpunuar, kemi këto të dhëna:

- 6 procedime penale me Italinë
- 3 procedime penale me Greqinë
- 2 procedime penale me Kosovën
- 1 procedim penal me Anglinë
- 1 procedim penal me Slloveninë

Nga 13 procedimet e përmendura më sipër, tashmë kanë përfunduar hetimet për 3 prej tyre (2 me Italinë, 1 me Slloveninë), ndërsa 10 të tjerat janë në proces.

Gjatë vitit 2010, Shqipëria ka bashkëpunuar me disa vende me qëllim mundësimin e arrestimit të personave të ndryshëm për t'i ekstraduar në Shqipëri dhe anasjelltas. Për qëllim ekstradimi në vendet e tjera (Hungari – Zyra e INTERPOLIT Budapest), në Shqipëri, për **vitin 2010**, është arrestuar **një person i akuzuar** për trafikim të qenieve njerëzore. Ndërsa për sa i përket ekstradimit në Shqipëri të personave të akuzuar për çështje penale të trafikimit të qenieve njerëzore dhe shfrytëzimit të prostitucionit, **kemi këto të dhëna:**

Shtetas shqiptarë të arrestuar jashtë me qëllim ekstradimi në Shqipëri për vitin 2010:

<i>Vendet</i>	<i>Për trafikim të qenieve njerëzore</i>	<i>Për shfrytëzim prostitucioni</i>
Itali	2 (trafikim i femrave)	2
Greqi	1 (trafikim i femrave)	2
Belgjikë	1 (trafikim i femrave)	0
Kosovë	1 (trafikim i femrave)	0
Zvicër		1
Gjermani		1
Francë		1
SHBA		1
Totali	5	8

Ekstradime në Shqipëri gjatë vitit 2010:

<i>Vendet</i>	<i>Për trafikim të qenieve njerëzore</i>	<i>Për shfrytëzim prostitucioni</i>
Itali	2 (trafikim i femrave)	4
Greqi	1 (trafikim i të miturve)	0
Spanjë		1
Gjermani		1
France		1
Totali	3	7

Referuar edhe të dhënave të mësipërme, rezulton se ka një rritje të bashkëpunimit me vendet e tjera në drejtim të hetimit dhe gjykimin të veprave penale për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Ministria e Drejtësisë gjatë vitit 2010 ka vazhduar përpjekjet për intensifikimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit gjyqësor në fushën e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Kanë filluar negociatat në nivel teknikësh për hartimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me *EUROJUST*. Në shtator 2010 u zhvilluan bisedime në nivel teknik mbi përmbajtjen e legjislacionit shqiptar për të analizuar mundësitë që ky i fundit ofron për lidhjen e një marrëveshjeje të tillë. Gjatë vitit 2010, janë miratuar edhe disa marrëveshje të reja bashkëpunimi me Mbretërinë e Belgjikës si dhe është miratuar në parim Protokollin e Tretë Shtesë i Konventës Evropiane “Për ekstradimin”⁶.

dh. Të dhëna statistikore në lidhje me hetimin dhe gjykimin⁷

Viti 2010 shënon një periudhë gjatë së cilës janë ndërmarrë masa të rëndësishme në kuadër të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, veçanërisht për sa i përket ndjekjes dhe drejtësisë penale. Vetëm **për periudhën janar – dhjetor 2010** nga ana e Policisë së Shtetit janë evidentuar **37 raste të trafikimit të qenieve njerëzore, 25 raste ose 67% më shumë se gjithë vitin e kaluar**.

Impakt shumë pozitiv në rritjen e forcës parandaluese e goditëse të trafikeve të paligjshme dhe në veçanti të trafikimit të qenieve njerëzore kanë patur rritja e kapaciteteve njerëzore⁸ dhe kompetencave të strukturave të zbatimit të ligjit, si dhe trajnimet e vazhdueshme⁹ të zhvilluara me strukturat e SKTP, duke rritur nivelin e tyre profesional dhe aftësinë investiguese. Hapa pozitivë janë shënuar edhe në drejtim të **gjykimin të çështjeve**, duke rritur shpejtësinë e gjykimin dhe marrjen e vendimeve, të cilat karakterizohen me dënime të ashpra ndaj autorëve të veprave penale.

Nga **Policia e Shtetit** për periudhën janar – dhjetor 2010, janë evidentuar në total **37 çështje** për trafikimin e qenieve njerëzore (**3 për “Trafikim personi”** – neni 110/a; **33 për “Trafikim femrash”** – neni 114/b dhe **1 rast për “Trafikim i të miturve”** – neni 128/b) me gjithsej **51 autorë**. Gjatë hetimit të rasteve të përmendura më sipër janë evidentuar edhe çështje me objekt trafikimin e brendshëm, si dhe nga informacioni më i fundit ka edhe një rast të trafikimit të fëmijëve me qëllim shfrytëzimin seksual dhe lypje në rrugët e Tiranës. Gjatë procesit të identifikimit të viktimave të trafikimit si dhe duke iu referuar të dhënave të regjistruara në bazën e të dhënave për viktimat e trafikimit, nga Policia e Shtetit janë regjistruar **3 procedime penale me objekt trafikimin e brendshëm**, përkatësisht 1 procedim për “Trafikimi personi” - neni 110/a (e dëmtuara

6 Për më shumë informacion, shih në kapitullin I “NDJEKJA PENALE” – pika a. Përmirësimi i Kuadrit Ligjor

7 Informacion nga Policia, Prokuroria, Gjykatat dhe Ministria e Drejtësisë

8 Për më shumë informacion shih në kapitullin I “NDJEKJA PENALE” – pika c. Rritja e kapaciteteve të strukturave të zbatimit të ligjit

9 Për informacion më të detajuar lidhur me trajnimet e zhvilluara shih kapitullin NDJEKJA PENALE – pika d – Ngritja e kapaciteteve të strukturave të zbatimit të ligjit

është shfrytëzuar për lypje), 1 procedim për “Trafikimi i femrave” - neni 114/b dhe 1 procedim për “Trafikimi i të miturve - neni 128/b (e dëmtuara është shfrytëzuar për lypje dhe shërbime seksuale). Për të gjitha çështjet e evidentuara është bërë referimi në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Për periudhën janar – dhjetor 2010, janë identifikuar nga PSH (SKTP dhe PKM) gjithsej **65 viktima/viktima të mundshme trafikimi (të gjitha femra).**

Statistika nga PSH lidhur me TQNJ për vitin 2010

Vepra Penale	Evidentuar	Autorë	Arrestuar	Gj.të lirë	Kërkim	Ndaluar
Traf. i femrave - 114/b	33	45	5	34	3	3
Traf. i personave - 110/a	3	3	0	3	0	0
Traf. të miturve - 128/b	1	3	3	0	0	0
TOTALI	37	51	8	37	3	3

Gjatë vitit 2010, nga Policia e Shtetit (SKTP) janë zhvilluar gjithsej **3 operacione** me objekt trafikimin e qenieve njerëzore (2 operacione për “Trafikim i femrave” dhe 1 operacion për veprën penale “Trafikim i të miturve”. Nga këto operacione janë goditur **3 grupe kriminale**, 2 për “Trafikim i femrave”, me 7 autorë, 3 të arrestuar në flagrancë, 3 të proceduar penalisht në gjendje të lirë dhe 1 i shpallur në kërkim, si dhe 1 grup kriminal për “Trafikim i të miturve”, me 3 autorë të arrestuar në flagrancë. Gjatë vitit 2010, janë **kapur gjithsej 21 persona** në kërkim, të akuzuar për trafikim të qenieve njerëzore (18 të akuzuar për “Trafikim i femrave” dhe 3 për veprën penale “Trafikim i të miturve”).

Njësia e Inteligjencës Financiare në **Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (D.P.P.P.P)** për vitin 2010 ka referuar gjithsej **185 raste të hetimeve financiare** pranë autoriteteve të zbatimit të ligjit për investigime të mëtejshme. Nga këto raste **8 kanë të bëjnë me veprën penale të trafikimit të qenieve njerëzore**. Gjithashtu, gjatë këtij viti DPPPP-ja ka kryer **investigim financiar për 274 raste**, për të cilat organet e zbatimit të ligjit (prokuroria dhe policia e shtetit) kanë kërkuar bashkëpunim. Shumë nga këto raste kanë patur si objekt hetimi edhe veprimtari kriminale të lidhura me trafikimin e qenieve njerëzore.

Në drejtim të **menaxhimit të kufijve**, tashmë është realizuar lidhja e sistemit TIMS në 24 Pikat e Kalimit të Kufirit (PKK) që janë në RSH, në tre Komisariate të Policisë së Kufirit dhe Migracionit (PKM) dhe në 8 Drejtori Rajonale të Kufirit dhe Migracionit (DRKM). Kjo lidhje mundëson transmetimin dhe shkëmbimin e informacionit në kohë reale për shërbimet e ofruara në PKM si dhe për intervistimin dhe identifikimin e viktimave mundshme të trafikimit, duke i pasqyruar të dhënat edhe në bazën e të dhënave për viktimat e trafikimit. Gjithashtu, është lidhur sistemi MEMEX në të gjitha DRKM.

Për fëmijët zbatohen procedura strikte kur ata udhëtojnë me njërin nga prindërit ose me persona të tjerë. Për këto raste kërkohet deklarata noteriale e prindërve që e lejon fëmijën të udhëtojë me njërin nga prindërit ose personat e tjerë. **Nga personat e intervistuar në kufi nga PKM në total janë identifikuar si viktima/viktima të mundshme trafikimi 17 persona (femra)** të gjitha me shtetësi shqiptare. Janë ndërtuar dhe **janë rikonstruktuar në PKK ambiente të përshtatshme për intervistimin dhe akomodimin e shtetasve, në veçanti të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit**. Janë kompletuar me pajisjet e nevojshme të punës të një teknologjie të lartë (kompjuter, printer, skaner për gjurmët e gishtave, aparat fotografik) sidomos PKK e miratuara për pritjen e shtetasve që kthehen nga policitë e vendeve të tjera.

Nga intervistat e zhvilluara në kufi, janë identifikuar si viktima të mundshme trafikimi **gjithsej 17 persona (femra), 13 të intervistuar në hyrje, 1 në dalje dhe 4 në tentativë për kalim kufiri.**

Në kuadër të **mbrojtjes së fëmijëve** dhe duke synuar parandalimin e trafikimit dhe shfrytëzimit të tyre, gjatë vitit 2010, është rritur forca goditëse ndaj çdo forme dhe veprimtarie kriminale që dëmton fëmijët. Sipas statistikave të Policisë së Shtetit, **për vitin 2010**, rezultojnë gjithsej **699 fëmijë të dëmtuar**¹⁰ nga vepra të ndryshme penale ndër të cilat **120 fëmijë të dëmtuar si rezultat i dhunës në familje**. Në drejtim të mbrojtjes së fëmijëve janë forcuar dhe qartësuar kapacitetet e Sektorit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Dhunën në Familje, duke rritur aftësitë mbrojtëse dhe parandaluese për të miturit në vend.

Gjatë vitit 2010, në **Prokurorinë për Krime të Rënda** janë hetuar **39 procedime penale** (sipas regjistrimit të njoftimit të veprave penale) që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore **nenet 114/b, 128/b, 110/a** nga të cilat 28 të reja të regjistruara gjatë vitit 2010, si dhe **11 të mbartura** nga vitet e mëparshme. Në Prokurorinë për Krime të Rënda kohët e fundit është regjistruar një procedim për veprën penale “Trafikimi i të miturve” – neni 128/b i KP, me **objekt trafikimin e brendshëm**. Për sa i përket procedimeve të tjera në lidhje me të miturit, nga të dhënat rezulton se ata trafikohen jashtë vendit për qëllime prostitucioni ose për lypje. Rastet e tjera të procedimeve penale të regjistruara në Prokurorinë për Krime të Rënda për veprën penale të trafikimit të qenieve njerëzore paraqiten si rastet më tipike të trafikimit me qëllim shfrytëzimi për prostitucion jashtë vendit (*Greqi, Itali, Kosovë*). Për sa i përket rasteve të regjistruara gjatë vitit 2010, sipas veprave penale, kemi këto tregues:

- 20 raste për veprën penale “Trafikim i femrave” - neni 114/b i KP;
- 2 raste për veprën penale “Trafikim i personave” - neni 110/a i KP;
- 6 raste për veprën penale “Trafikim i të miturve” - 128/b i KP.

Treguesit e procedimeve penale (*nenet 114/b, 128/b, 110/a*) të mbartura nga viti 2008-2009 paraqiten si vijon:

- 9 procedime për veprën penale “Trafikimi i femrave” - neni 114/b i KP;
- 2 procedime për veprën penale “Trafikimi i të miturve” - neni 128/b i KP.

Për të gjitha procedimet penale që lidhen me veprën penale të trafikimit të qenieve njerëzore (*të regjistruara në vitin 2010 si dhe të mbartura nga viti 2008-2009*), në regjistrin e njoftimit të veprave penale janë regjistruar emrat e **29 shtetasve** si persona që iu atribuohet kryerja e veprës penale.

Në **Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda** për vitin 2010 janë trajtuar **19 çështje** me objekt trafikimin e qenieve njerëzore, prej të cilave **8 të reja, 10 të mbartura** nga viti 2009 dhe **1 e ardhur për rigjykim**. Gjatë vitit 2010 ka **përfunduar gjykimi për 7 çështje**, për 1 çështje i janë kthyer aktet Prokurorisë dhe 11 të tjera janë ende në gjykim. Në këto çështje janë sjellë **për gjykim gjithsej 27 persona**. Në çështjet e përfunduara janë **dënuar 11 persona** me dënime që variojnë nga **7 – 15 vjet burgim** dhe me gjobë nga **3 - 4 milion lekë ose 29.411 – 39.215 \$ (USD)**. Sipas cilësimit juridik të veprave penale kemi këtë ndarje:

- 3 çështje për veprën penale “Trafikimi i fëmijëve” - neni 128/b KP, në dy prej tyre janë të akuzuar nga një i pandehur, në një të pandehur (gjithsej 5 të pandehur);
- 15 çështje për veprën penale “Trafikimi i femrave” - neni 114/b KP (4 çështje u regjistruan në dhjetor 2010) për të cilat akuzohen 21 persona të sjellë për gjykim;
- Në 1 çështje me tre të pandehur ka ndryshuar kualifikimi ligjor në “Shfrytëzim prostitucioni në rrethana rënduese” sipas nenit 114/a, 5 e 6 të K. Penal.

Ndërsa nga informacioni i marrë nga **Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda**, rezulton se nga kjo gjykatë gjatë vitit 2010 janë trajtuar gjithsej **9 çështje** me objekt trafikimin e qenieve njerëzore (8 të regjistruara të reja gjatë 2010 dhe 1 e mbartur nga 2009). Janë marrë **vendime për 7 çështje** dhe **2 janë** në proces gjykimi¹¹. Vendimet e marra kanë konkluduar në lënie në fuqi të vendimit

10 Për informacion më të plotë për fëmijët e dëmtuar nga vepra të ndryshme penale për vitin 2010 shiko në fund të raportit – Aneks IV

11 Për më shumë informacion shikoni tabelën me të dhënat nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda në fund të raportit tek Aneks III.

të gjykatës së shkallës së parë (për 4 çështje), mospranim ankimi (2 çështje) dhe vetëm në një çështje për 2 nga 4 autorët e veprës penale ka ndryshuar cilësimi juridik i veprës penale nga neni 114/b në 109/a i KP "Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit në rrethana lehtësuese" dhe për rrjedhojë edhe ulja e masës së dënimit nga 10 në 5 vjet burg. Nga këto të dhëna mund të arrijmë në përfundimin se, për çështjet e gjykuara me objekt trafikimin e qenieve njerëzore, janë unifikuar qëndrimet e gjykatave në shkallë të ndryshme të gjykimit.

e. Gjetje dhe rekomandime

1. **Të rriten hetimet proaktive** si për evidentimin e rasteve të trafikimit ashtu edhe për identifikimin e viktimave të trafikimit:
 - a. Fokusimi tek trafikimi i brendshëm dhe trafikimi i fëmijëve me qëllim shfrytëzimin për punë, lypje apo forma të tjera, përveç atij seksual;
 - b. Të shfrytëzohet çdo informacion i ardhur nga burime të ndryshme dhe të nxiten hetimi dhe hapja e procedimeve mbi këtë bazë;
2. **Rritja e bashkëpunimit me shoqërinë civile**, strukturat në nivel vendor dhe me vetë viktimat e trafikimit.
 - a. Të nxiten strukturat e zbatimit të ligjit që të bashkëpunojnë më shumë me shoqërinë civile si dhe me agjencitë e tjera shtetërore dhe joshtetërore, sidomos ato në nivel vendor;
 - b. Duhet të garantohet siguria e viktimës dhe të merren masat e duhura për mbrojtjen dhe mbështetjen e saj nga organet e hetimit, si dhe në rast nevojë përfshirjen në programin e mbrojtjes së dëshmitarit.
3. **Përmirësimi i të dhënave statistikore** nga të gjitha agjencitë raportuese.
 - a. Të gjitha agjencitë duhet të vazhdojnë të përpunojnë të dhëna më të hollësishme për çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore duke i plotësuar me rubrika të reja me të dhëna si për autorët e veprave penale, ashtu edhe për viktimat e trafikimit, për kategoritë tyre, llojet e shfrytëzimit në mënyrë që të bëhet një analizë më e qartë e situatës;
 - b. Ministria e Drejtësisë duhet të koordinojë punën me të gjitha strukturat e tjera, për prodhimin e statistikave të konsoliduara për çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore. Këto statistika duhet të unifikohen dhe të standardizohen. Është shumë e rëndësishme që statistikat e prodhuara nga Ministria e Drejtësisë, Policia dhe Prokuroria të përmbajnë të dhëna për të gjitha fazat e gjykimit;
 - c. Të pasqyrohen të dhëna për mënyrën e ecurisë së çështjes që nga regjistrimi i saj deri në përfundim të gjykimit dhe dhënies së vendimit të formës së prerë.
4. **Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar** sidomos me vendet fqinjë dhe vendet e destinacionit.
 - a. Intensifikimi i përpjekjeve për rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në veçanti me vendet fqinjë (Greqia dhe Kosova) për evidentimin e rasteve të trafikimit me qëllim shfrytëzimi për punë, lypje etj;
 - b. Mbajtja e kontakteve të rregullta me përfaqësitë tona diplomatike dhe oficerët e kontaktit, si dhe me agjencitë e vendeve të tjera homologe për të mundësuar në kohë shkëmbimin e informacionit për ndjekjen e rasteve si dhe për identifikimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit;
 - c. Forcimi i bashkëpunimit me zyrat e emigracionit dhe punësimit në Shqipëri për të parandaluar emigracionin e paligjshëm shfrytëzimin me destinacion Shqipërinë.

Mbrojta dhe Asistenca ndaj Viktimave të Trafikimit

Në vijim të këtij kapitulli do të gjeni një përshkrim të aktiviteteve kryesore të realizuara dhe problematikave në fushën e mbrojtjes dhe asistencës ndaj viktimave të trafikimit. Kjo *shtyllë strategjike* është e lidhur ngushtë me viktimën e trafikimit dhe ngritjen e mekanizmave për t'i ardhur në ndihmë asaj/atij. Me mbrojtje dhe asistencë kuptojmë të gjithë procesin e identifikimit, referimit, përfitimit të shërbimeve këshillimore, shëndetësore (si për viktimat në qendra dhe për viktimat që nuk akomodohen në qendra rezidenciale), rehabilitimit, riintegrit, dhe monitorimit të rasteve në vazhdimësi.

Identifikimi i një viktime trafikimi është vlerësuar si faza më e rëndësishme e procesit të mbrojtjes dhe asistencës. Ky proces i hap rrugën shpëtimit të një viktime nga kthetrat e trafikimit dhe bën të mundur kalimin e saj në duart e institucioneve ndihmëse. **Gjatë vitit 2010, në qendrat rezidenciale kanë marrë shërbim 97 viktima trafikimi, nga të cilët 83 të rritur dhe 14 fëmijë.** Gjatë vitit 2010, nuk janë identifikuar meshkuj viktima trafikimi. Qeveria Shqiptare jep kontribut me shërbime rehabilituese dhe integruese falas si dhe me ndihmë direkte financiare direkte për qendrat pritëse dhe viktimat e trafikimit. Shqipëria ofron shumë mundësi që viktima e trafikimit të marrë asistencën e nevojshme dhe një shans të dytë për të filluar një jetë normale. Të gjitha rastet e identifikuar kanë marrë mbrojtjen dhe asistencën e nevojshme. Për këtë, kontribut themelor kanë dhënë qendrat rezidenciale për viktimat e trafikimit, palë të Mekanizmit Kombëtar të Referimit¹². Një element mjaft i rëndësishëm i luftës dhe parandalimit të trafikimit është dhe inkurajimi i viktimave të trafikimit për të dëshmuar në procedimet penale, por në përmbushjen e këtij qëllimi institucionet duhet të sigurojnë mbrojtjen e viktimës gjatë procesit gjyqësor dhe më pas. Asistenca dhe mbrojtja e viktimës nuk është e kushtëzuar nga bashkëpunimi i viktimës me organet e drejtësisë.

1. Plotësimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen dhe asistencën e viktimave të trafikimit

Një hap shumë i rëndësishëm i vitit 2010 është miratimi i Ligjit “Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore”, i cili është i fokusuar në dy drejtime:

1. *Financim nga buxheti i shtetit për qendrat pritëse jopublike.* Në zbatim të Nenit 4, të Ligjit nr. 10252, datë 11.03.2010 “Për disa ndryshime në Ligjin 9355, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 10355, datë 02.12.2010 “Për Buxhetin e Vitit 2011”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 4, datë 27.01.2011 “Për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për Vitin 2011, Ministria e Punës transferon fonde (ushqimi) në Programin e “Mbrojtjes Sociale” për përfituesit Viktima Trafikimi, që marrin shërbime shoqërore në ofruesit e shërbimeve jo-publike: Tjetër Vizion, Të Ndryshëm dhe të Barabartë, Vatra dhe Qendra Komunitare Gjirokastër për periudhën 6 mujore.
2. Në përputhje me po këtë ligj, *viktimat e trafikimit*, përveç shërbimeve sociale të ofruara gjatë akomodimit të tyre në qendrat pritëse dhe ri-integruese, *përfitojnë tashmë ndihmë ekonomike pas daljes nga qendra rezidenciale deri në momentin e punësimit të tyre*¹³. Ky hap shpreh angazhimin që Qeveria Shqiptare ka siguruar vazhdimësinë dhe forcimin e shërbimeve të qendrave pritëse, të cilat deri më sot janë financuar nga projekte të donatorëve partnerë.

12 Mekanizmi Kombëtar i Referimit për Viktimat e Trafikimit është ngritur mbi bazën e Marrëveshjes së Bashkëpunimit “Për Krijimin e një Mekanizmi Kombëtar Referues për Identifikimin dhe Asistencë të Përmirësuar për Viktimat e Trafikimit” ndërmjet Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Qendrës Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit, Drejtorisë së Policisë së Shtetit, Ministrisë së Punëve të Jashtme, Organizatës Jo-Fitimprurëse “Vatra”, Organizatës Jo-Fitimprurëse “Tjetër Vizion” dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM).

13 Vendimi nr. 796, date 8.09.2010 “Për disa Shtesa dhe Ndryshime në Vendimin nr. 787 date 14.12.2005 të Këshillit të Ministrave “Për Caktimin e Kriteve, të Procedurave dhe të Masës së Ndhimës Ekonomike”, të ndryshuar”

Gjithashtu, gjatë vitit 2010, ZKKA ngriti dy grupe pune me përfaqësues të agjencive shtetërore, OJF-ve vendase dhe organizatave ndërkombëtare aktive dhe me ekspertizë në fushën e trafikimit për të analizuar dhe për të rekomanduar iniciativa dhe masa të cilat do të bëjnë të mundur përmirësimin e legjislacionit dhe forcimin e mekanizmave të ndjekjes penale, mbrojtjes, asistencës, parandalimit dhe koordinimit të aktiviteteve antitrafik. Grupi i parë¹⁴ u ngrit për të kryer vlerësimin e legjislacionit lidhur me zbatimin e *Konventës së Këshillit të Evropës “Për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore”*. Grupi vlerësoi përputhshmërinë e legjislacionit shqiptar dhe mekanizmave të kërkuara nga *Konventa*. Grupi i dytë i punës¹⁵ u ngrit për të kryer vlerësimin e legjislacionit dhe ngritjen e një sistemi monitorimi dhe mbrojtjeje për fëmijët e shfrytëzuar.

Gjatë kësaj kohe u miratua Ligji “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës” nr 10347, 04.11.2010. Ky ligj synon të krijojë kushtet e përshtatshme për hartimin dhe zbatimin e politikave që ndikojnë mbi të drejtat e fëmijëve, duke i përshtatur ato me standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, ky ligj për herë të parë realizon vendosjen e një sistemi efektiv vëzhgimi dhe raportimi lidhur me realizimin e të drejtave të fëmijëve në nivel qendror dhe vendor dhe janë parashikuar mekanizmat institucionalë, të cilat do të jenë përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji dhe garante për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në përgjithësi.

Me VKM nr. 1008, datë 10.12.2010 është miratuar kalimi në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të pronës në Libohovë, Gjirokastër për ta përdorur për ngritjen e Qendrës Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit në zonën jugore të vendit.

2. Garantimi i shërbimeve të asistencës ndaj viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit

Nga vlerësimet e deritanishme mund të konkludojmë se *Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit dhe qendrat e tjera jo shtetërore* kanë vendndodhje të shpërndarë, duke bërë të mundur mbulimin e nevojave në qarqe të ndryshme të vendit (Tiranë, Elbasan, Vlorë). Gjithashtu, ekspertiza e stafeve të këtyre qendrave bën të mundur realizimin e ndihmës dhe mbështetjes gjithëpërfshirëse për viktimat e trafikimit. Pas akomodimit në qendër, viktimat e trafikimit përfitojnë përmbushje të nevojave themelore. Brenda një afati të përcaktuar dyjavor kryhet vlerësimi i nevojave (psiko-sociale, shëndetësore, ligjore, aftësim profesional). Në përputhje me këto nevoja, punonjësi social i ngarkuar harton planin e ndihmës për viktimat e trafikimit, sigurisht, duke marrë dhe aprovimin e viktimës në këtë rast.

Kujtojmë se tashmë qendrat rezidenciale punojnë me standarde të qarta pune. *Standardet*¹⁶ janë hartuar nga një grup i gjerë aktorësh kryesuar nga MPCSSHB. Tashmë, MPCSSHB ka miratuar *Udhëzuesin*¹⁷ dhe *Manualin shoqërues* për zbatimin e standardeve, një dokument i cili u vjen në ndihmë ofruesve të shërbimeve sociale (qendrave rezidenciale publike dhe jopublike). Udhëzuesi dhe manuali shoqërues përmbajnë formularë dhe procedura, të cilat kanë si synim të qartësojnë dhe unifikojnë veprimet e ofruesve të shërbimeve dhe inspektorëve monitorues, indikatorët që duhet të përdoren gjatë inspektimit për të monitoruar dhe vlerësuar zbatimin e standardeve në

14 Ngritur me Urdhër nr. 32, datë 05.02.2010 “Për Ngritjen e Grupit të Punës për të Analizuar dhe Hartuar një Raport të Brendshëm mbi Zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës në Legjislacionin Vendas për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore

15 Ngritur me Urdhër nr. 31, datë 5.2.2010 “Për Ngritjen e Grupit të Punës mbi Masat që do të Merren me Masat Zbatuese për Përmirësimin e Legjislacionit në lidhje me Parandalimin dhe Luftën ndaj Punës së Fëmijëve

16 VKM Nr. 195, datë 11.4.2007 “Standardet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimi”

17 Udhëzimi i Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr. 316, dt. 10.02.2010 “Për Zbatimin e Standardeve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimi”

qendrat e licensuara. Këto dokumente janë hartuar në bashkëpunim me UNICEF.

Gjatë periudhës 6 Shtator 2010 deri në datën 23 Tetor 2010, MPÇSSHB në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare Burimore të Trajnimit dhe Asistencës Teknike (ANTTARC) dhe me mbështetjen e UNICEF, realizoi Trajnimin mbi “Rritjen e kapaciteteve të stafit të qendrave rezidenciale për viktimat e trafikimit dhe personat në rrezik trafikimi”. Në këtë kuadër u organizuan një seri trajnimesh në qytetet ku qendrat rezidenciale operojnë (Tiranë, Vlorë, dhe Elbasan) me pjesëmarrjen e **131 personave**. Objektivat e kurseve të trajnimit: Rritje e kapacitetit të stafit të qendrave rezidenciale për viktimat e trafikimit dhe personat në rrezik trafikimi duke u bazuar në procedurat, protokollet dhe format standarde të përdorura; Rritja e cilësisë së përkujdesit për viktimat e trafikimit dhe personat që janë në rrezik trafikimi.

- Kursi i parë i trajnimit u organizua në Tiranë në datat 6-8 shtator 2010, me pjesëmarrjen e 35 personave;
- Kursi i dytë i trajnimit u organizua në Tiranë në datat 13-15 shtator 2010, me pjesëmarrjen e 26 personave;
- Në datat 5-7 tetor 2010, u zhvillua kursi i tretë i trajnimit në qytetin e Vlorës me pjesëmarrjen e 25 personave;
- Në datat 12-14 tetor 2010 u zhvillua kursi i katërt i trajnimit në qytetin e Gjirokastrës me pjesëmarrjen e 26 personave;
- Kursi i pestë dhe i fundit i trajnimit u zhvillua në qytetin e Elbasanit në datat 20-22 tetor 2010, me pjesëmarrjen e 18 personave.

Programi i trajnimit u përqendrua në standardet, protokollet dhe format e tjera të zhvilluara së fundmi për shërbimet e kujdesit social për viktimat e trafikimit dhe personat që janë në rrezik trafikimi. (*Standardet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror në Qendrat Rezidenciale për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimi*, miratuar me VKM nr. 195 datë 11.4.2007; Udhëzimi i Ministrit të Punës nr 316, date 10.02.2010 “Për Zbatimin e Standardeve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror në Qendrat Rezidenciale për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimi” si edhe Formularët përmbledhës të ofruesit të shërbimeve.

Pjesëmarrësit në trajnim ishin përfaqësues të: Shërbimit Social Shtetëror, Sektorët Socialë pranë bashkive, Drejtoritë rajonale të Policive, Ofruesit e Shërbimeve (Qendrat Rezidenciale për viktimat e trafikimit dhe ato në rrezik) përfaqësues nga Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve, Prefektura, përfaqësues të (OJF (Organizata Terre des Homme) etj.

2.a Aktiviteti i qendrave

Qendrat që operojnë në Shqipëri janë të specializuara për të ofruar shërbime për viktimat e trafikimit (femra, meshkuj, fëmijë ose të rritur). Në këto qendra vendosen viktima shqiptare dhe të huaja. VeT fëmijë vendosen në të njëjtat qendra, por në vendndodhje të ndryshme brenda qendrës, të cilat janë më të përshtatshme për fëmijët. VeT meshkuj vendosen në të njëjtat qendra, por në vendndodhje të ndryshme brenda qendrës, të ndarë nga femrat dhe fëmijët. Të gjitha viktimat marrin trajtim të njëjtë, bazuar në nevojat e personit, hartohet një program i individualizuar trajtimi dhe riintegrimi (konsultim, kujdes mjekësor, kujdes psikologjik, trajnim profesional, ndërmjetësim me familjen etj). Qendrat bashkëpunojnë fort me Drejtoritë Rajonale të Punësimit, të Shëndetit Publik, të Arsimit etj. Për vitin 2010 QKPVT ka përfutur 28.4 Milion Lek financim, për vitin 2011 Qendra do të përfutojë 39.4 Milion Lek ose 39% më shumë sesa në vitin 2010.

Gjatë vitit 2010 kanë përfutur shërbime në qendrat publike dhe jopublike **97 persona** (viktima trafikimi apo persona në rrezik trafikimi), **14 fëmijë dhe 83 të rritur**. Gjatë vitit 2010, nuk janë identifikuar meshkuj, viktima trafikimi. Shërbimet i janë ofruar viktimës pavarësisht nga vullneti i tyre për të bashkëpunuar me autoritetet. Gjatë po kësaj periudhe rezulton se nuk ka raste të refuzimit nga ana e viktimave të identifikuara të ndihmës së ofruar nga qendrat. Qendrat arrijnë të sigurojnë:

a. Informacion:

Stafi i qendrave informon viktimën mbi të drejtat e saj dhe për çdo veprim të ndërmarrë merret miratimi paraprak i viktimës.

Në qendra në bashkëpunim me organizata të tjera vendase që ofrojnë shërbime juridike, viktimës i ofrohet edhe informacion ligjor. Por, **gjatë vitit 2010**, në bazë të Urdhrit nr. 723/1, datë 30.9.2010 **është caktuar një oficer e Policisë Gjyqësore pranë PP e ngarkuar me mbajtjen e kontakteve të vazhdueshme me viktimat në çdo fazë të hetimit apo gjykimit të çështjes**. Qëllimi i krijimit të këtij funksioni të ri është krijimi i kushteve sa më të përshtatshme për viktimat gjatë bashkëpunimit me Prokurorinë, dhënien e ndihmës psikologjike apo çdo lloj ndihme tjetër që mund të sigurohet nga ana e Prokurorisë, si edhe lehtësimi i komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave ndërmjet Prokurorisë dhe qendrave.

Gjithashtu, krijimi i “*Seksionit për Hetimin e Çështjeve që Lidhen me Trafikimin e Qenieve Njerëzore*” në PP ka krijuar lehtësi komunikimi direkt të dy prokuroreve me OPGJ-të në Drejtoritë e Qarqeve për t’iu ofruar konsultimin e duhur ligjor në rastet e ndjekjes së veprave penale të trafikimit. Konsultimi ligjor konsiston, ndërmjet të tjerave, edhe në mbrojtjen që duhet t’i ofrojnë viktimës; strehimin e viktimës në një qendër.

Shembuj: QKPVT, gjatë vitit 2010, ka bashkëpunuar me oficerët antitrafik. Gjatë bashkëpunimit me drejtësinë, viktimave u është ofruar këshillim dhe asistencë ligjore. Qendra “*Të ndryshëm dhe të Barabartë (N&B)*” ka bashkëpunuar me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare (QNLQ). “*20 përfituese të asistuar në programin e riintegritimit kanë denoncuar trafikantët. Përveç bashkëpunimit me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare, N&B ka bashkëpunuar dhe me policinë dhe Prokurorinë e Krimeve të Rënda në mënyrë që të mbështeten përfitueset në ndjekjen e proceseve, marrjen e informacionit lidhur me këto çështje dhe mbështetja për sigurinë e përfitueseve. Përfitueset kanë kontaktuar me avokaten e QNLQ edhe për mundësinë e kompensimit. Të gjitha përfitueset janë mbështetur për t’u pajisur me dokumente identifikimi dhe janë shoqëruar në vendet e tyre të origjinës për të bërë aplikimin për kartë identiteti apo pasaportë*”.

Qendra “*Vatra*” ofron asistencë ligjore nëpërmjet avokatit të qendrës. Format e asistencës janë: asistim direkt i rasteve, këshillime individuale dhe trajnime në grup. Janë asistuar 2 viktima trafikimi dhe 1 në rrezik. Në bashkëpunim me Qendrën për Nisma Ligjore dhe Qytetare, avokati i Qendrës është duke ndjekur procedurat ligjore për një viktimë trafikimi për të përfituar dëmshpërblimin.

B. Siguri dhe mbrojtje:

Qendrat rezidenciale publike dhe jopublike kanë bërë të mundur të sigurojnë viktimat, ambientet e qendrës dhe stafin e tyre. Viktima e trafikimit nuk ndëshkohet për veprimet që ka bërë gjatë periudhës së trafikimit.

c. Përkujdesje:

Në qendrat rezidenciale, viktima e trafikimit përfiton:

- Strehim:

Viktimat e trafikimit qëndrojnë në *qendër* për sa kohë është i nevojshëm qëndrimi për të përmbushur procesin e rehabilitimit të viktimës dhe përgatitjen për riintegrimin e saj në jetën sociale.

- Këshillim psikologjik në qendër:

Në qendrat për viktimat e trafikimit, seancat e këshillimit ofrohen nga stafi i vetë qendrës (nga psikologu apo punonjësi social) apo nga psikologë të jashtëm që bashkëpunojnë me qendrën. Ky shërbim i ofrohet përfituesit në vazhdimësi. Ky shërbim mundësohet për të gjitha viktimat e trafikimit në vazhdimësi. Në total, më shumë se 400 seanca konsultimi janë zhvilluar në qendra.

Shembuj: Qendra “Të Ndryshëm dhe të Barabartë” Tiranë, ofron këshillim i cili e vë theksin tek *“përshatja me ambientin, reduktimi i traumës, përmirësimi i gjendjes psikologjike e rritjes së vetëvlerësimit e duke vazhduar më pas me marrëdhëniet me familjen, rëndësia e ndjekjes së kursit, punësimi e qëndrueshmëria në punë, përgatitjet për fazat e tjera, jeta e pavarur, e ardhmja etj.”*. Në QKPVT Tiranë, mbështetja psikologjike u ofrohet viktimave nga *“Klinika Ligjore për të Miturit” çdo ditë të premte, nëpërmjet seancave lehtësuese dhe ndërgjegjësuere për problemet dhe shqetësimet e hasura gjatë javës*. Në Qendrën “Vatra”, këshillimet kryhen nga psikologu i qendrës; këshillimet janë individuale dhe në grup. *“Tematika e këshillimeve në grup është përzgjedhur në bazë të problematikës që është vënë re në grupin e përfitueseve të alternuara me biseda të lira dhe me lojëra psikologjike si mënyrë efektive e shprehjes lirshëm të vetvetes dhe e daljes nga rutina e jetës së përditshme.”*

- Ndërmjetësim me familjen:

Qendrat informojnë se përfitueset e shërbimeve të tyre mbështeten e ndihmohen nga organizatat edhe gjatë qëndrimit në familje. Gjatë qëndrimit në qendër, përfitueset komunikojnë rregullisht me të afërmit e tyre, shoqërohen për të takuar të afërmit (brenda garancive të sigurisë) Por, qendrat raportojnë se *“VeT paragjykohe nga familja, të afërmit, komuniteti në të cilin jetojnë. Mentaliteti bëhet pengesë që vetë familja të pranojë vajzën e vet si viktimë trafikimi dhe ta lejojë atë të kthehet pranë familjes dhe të bëjë një jetë normale.”* Stafet e qendrave punojnë shpesh me familjet për të facilituar komunikimin dhe kthimin e përfitueses pranë familjes.

- Asistencë shëndetësore

VeT kanë nevojë të domosdoshme për kontroll e kujdes shëndetësor. Qendrat (mjeku i qendrës) kryejnë kontrole rutinë, diagnostikime, ekzaminime specifike, trajtim me medikament, edukim shëndetësor, ndjekje dhe monitorim të rasteve. Problemet janë të natyrave të ndryshme (dentare, okulistike, dermatologjike, neurologjike, gjinekologjike) Problemet e rënda trajtohen nga mjekë specialistë. Rastet me probleme shëndetësore mendore ndiqen nga psikiatri. Qendra “Vatra” raporton se, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetit Publik, Vlorë janë realizuar falas analiza; gjithashtu, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Qendrën e Gruas “Aulona”, Vlorë, janë realizuar falas vizita gjinekologjike.

Qendrat raportojnë se mbetet problem trajtimi i rasteve të përfitueseve me varësi nga droga, me probleme të shëndetit mendor, Hepatitit C, trajtim stomatologjik etj., të cilat kërkojnë jo vetëm trajtim special në kushte të veçanta spitalore, por edhe një kosto të lartë financiare, të papërbalueshme nga qendrat.

Gjithashtu, qendrat zhvillojnë sesione informimi të përfitueseve për kujdesin e tyre shëndetësor; format e informimit janë të ndryshme: biseda në grup, këshillime individuale etj. Qendra “Vatra” informon se tematikat e trajtuara janë mbi: higjienën personale, infeksionet seksualisht të transmetueshme, Hepatitin B, C, HIV/SIDA, shqetësimet e aparatit tretës, mbi gripin dhe influencat e tij, kujdesi ndaj përdorimit të ushqimeve, në mënyrë të veçantë në periudhën e verës etj. Të gjitha VeT ekzaminohen; asistencë speciale i jepet viktimave që kanë nevojë. *Vatra* raporton se, në total, numri i ekzaminimeve është 181. I njëjti numër ekzaminimesh jepet dhe në qendrat e tjera.

d. Rehabilitim:

Viktima bëhet pjesë e programeve edukuese për aftësim profesional. Qendrat ofrojnë në mënyrë të vazhdueshme trajnime profesionale, kurse profesionale, aktivitete tematike etj._

- Aftësim profesional

Qendrat ofrojnë mundësi për të forcuar aftësimin profesional të viktimave të trafikimit. Vetë qendrat dhe në bashkëpunim me Zyrat Rajonale të Punësimit ofrojnë kurse të ndryshme profesionale dhe trajnime për punësim kryesisht pa-pagesë: parukeri, rrobaqepësi, kuzhinë, punëtore shtëpie, anglisht, kompjuter, punë artizanale. Në qendrën “*Të Ndryshëm dhe të Barabartë*” 34 raste kanë ndjekur kurse të ndryshme. *Vatra* raporton se kanë përfituar kurse me ndihmën e Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional, Vlorë **12** gra dhe vajza, të cilat janë certifikuar në kurset përkatëse të parukerisë dhe rrobaqepësisë.

- Arsimim:

Qendrat bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme me Drejtoritë Arsimore për regjistrimin e përfitueseve në sistemin shkollor. Gjithashtu, ZKKA ka ndërmjetësuar me MASH për raste specifike apo të veçanta. Qendra “*Të Ndryshëm dhe të Barabartë*” raporton se **18 përfituese** kanë ndjekur shkollën. Në sajë të projekteve të donatorëve, është bërë i mundur mbulimi i shpenzimeve të disa kurseve profesionale, të cilat nuk mund të ofroheshin falas nga Qendra e Formimit Profesional; janë mbështetur me libra dhe mjete të nevojshme mësimore, janë kryer trajnime të ndryshme. *Vatra* raporton se **9 përfituese** janë regjistruar në shkollë dhe janë duke ndjekur shkollën aktualisht. Gjithashtu, **4 përfituese**, të cilat qëndrojnë me familjet e tyre janë duke ndjekur shkollën. Qendra “*Vatra*” dhe qendra të tjera ofrojnë për përfitueset mundësinë e leximit të librave artistikë” me qëllim ngritjen e nivelit të tyre kulturor dhe arsimor”. Për t’u ardhur në ndihmë përfitueseve të cilat ndjekin shkollën, mësuesi i qendrës *Vatra* zhvillon orë ditore mësimore për t’i ndihmuar ato në përvetësimin e mësimave të lëndëve përkatëse. Gjithashtu, Qendra “*Vatra*” ka bërë të mundur regjistrimin falas për këtë vit të fëmijës së një prej përfitueseve të qendrës. *Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit* ka zhvilluar orë letrare me përfitueset e qendrave. **Nga 97 VT, 31 janë duke ndjekur shkollën.**

- Aktivitete:

Qendra “*Të Ndryshëm dhe të Barabartë*” ka bashkëpunuar me AAGW për aktivitete të tilla ku përfitueset e programit kanë bërë punë dore të cilat janë shitur e me këto të ardhura janë paguar vajzat. Gjithashtu, është organizuar një trajnim lidhur me punët e dorës për të servitur në panairë punë dore të reja. 10 përfituese kanë marrë pjesë në trajnimin e punëve artizanale organizuar nga “*Të Ndryshëm dhe të Barabartë*”, ofruar nga një trajnere specialiste. Gjatë vitit 2010, janë organizuar dy panairë tek Sheraton një prej të cilave në Dhjetor “*Christmas Bazaar*” ku u shitën punimet e përfitueseve të “*Të Ndryshëm dhe të Barabartë*”.

Qendrat kanë zhvilluar aktivitetet okupacionale si kopshtaria, lojërat sportive, aktivitete relaksuese, kurse qëndristarie dhe punime me dorë. Në Qendrën “*Vatra*”, përfitueset të cilat ndjekin kurset profesionale, ushtrohen në ambientet e strehëzës në makina qepëse, në kompjuter, kuzhinë, pranë këndit të parukerisë, që u ofrohen në ambientin e brendshëm të strehëzës. Vizitat në pikat turistike apo muzeale janë aktivitetet të cilat zhvillohen për t’i njohur përfitueset me vlerat kulturore, historike të vendit tonë.

e. Ri-integrim:

Viktimat do të përfitojnë ndihmë ekonomike pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror (qendrat pritëse) deri në momentin e punësimit të tyre.

- Aktivitetet për rritjen e aftësive për jetën:

Është punuar me vajzat që kanë ndjekur kurse e me ato të cilat kanë ndjekur shkollën. Gjithashtu, është punuar në shkrim e lexim me rastet të cilat nuk kanë bërë asnjë klasë shkollë. Janë organizuar trajnime me tema të ndryshme: zhvillimi psiko-social i fëmijëve; ndihma e parë; shërbimet në komunitet etj.

- Përgatitja për punë dhe punësimi, ngritje e mikrobizneseve:

Qendra “*Të Ndryshëm dhe të Barabartë*” informon se **20 përfituese u punësuan** gjatë vitit 2010 kryesisht si rrobaqepëse, kuzhinierë, asistente kuzhinierë, shitëse në dyqan, pastruese, arkëtare, operatore, parukiere, magazinierë. Qendrat informojnë se ato bashkëpunojnë vazhdimisht me Zyrrat Rajonale të Punës. Të gjitha përfitueset regjistrohen pranë këtyre Zyrrave dhe disa prej tyre kanë përfituar nga programet e nxitjes së punësimit. Problem mbetet qëndrueshmëria e punësimit të viktimave me programe më intensive. Qendra “*Vatra*” raporton se **7 përfituese** kanë përfituar nga programet e nxitjes së punësimit. Në bazë të Vendimit Nr. 796, datë 8.09.2010, stafet e qendrave janë duke mbështetur disa prej viktimave të trafikimit në procesin e marrjes së ndihmës ekonomike.

Qendra “*Të Ndryshëm dhe të Barabartë*” ka asistuar **5 përfituese** të tjera për hapjen e mikrobizneseve këtë vit nga të cilat **2 përfituese** kanë hapur mini-rrobaqepësi me grante mbështetur nga IOM dhe 3 përfituese të tjera kanë hapur parukeri me grante të mbështetur nga IOM dhe Ministria e Jashtme e Norvegjisë. Mikrobizneset janë ngritur pranë qyteteve ku po riintegrohen përfitueset si në Kavajë, Berat, Durrës, Tiranë. Gjithashtu, kjo Qendër ka monitoruar edhe 6 përfitueset e tjera, të cilat i kanë hapur mikrobizneset më përpara. *Vatra* po punon fuqishëm me donatorë dhe organizata të tjera ndërkombëtare për ngritje fondesh, të cilat po përdoren për ngritje mikro-biznesesh me qëllim fuqizimin ekonomik të viktimave si e vetmja alternativë e suksesshme për kthimin e tyre në normalitet. Vetëm për 4 – mujorin e fundit të vitit janë vlerësuar 16 raste, nga të cilat për 2 prej tyre u bë e mundur ngritja e mikrobizneseve (me mbështetjen e IOM), duke e çuar në **8 numrin total të mikrobizneseve të ngritura nga Vatra** me fonde falas nga donatorët ndërkombëtarë në mbështetje të viktimave. Këto mikrobiznese monitorohen dhe ndiqen nga stafi i *Vatres* çdo muaj, për të parë nga afër ecurinë e tyre, problemet dhe vështirësitë që hasin gjatë menaxhimit të biznesit, jepen këshilla si dhe alternativa për zgjidhjen e tyre etj. **Nga 97 VT, 34 janë punësuar apo janë asistuar në hapjen e mikrobizneseve.**

- Strehimi:

Qendra “*Vatra*” raporton se kanë dalë nga qendra dhe janë ndjekur në **apartament me qera 3 përfituese** të trajtuara në qendër. *Të Ndryshëm dhe të Barabartë* raporton se **24 raste janë mbështetur financiarisht për pagesën e qirasë së apartamentit**. Plani i ri Kombëtar Antitrafik 2011-2013 ka parashikuar aktivitete të cilat do të bëjnë të mundur hartimin e një plani, i cili do të bëjë të mundur shtimin e mundësive për strehim për VeT.

F. Monitorimi dhe ndjekja e rasteve

Qendrat vazhdojnë të monitorojnë përfitueset e qendrave dhe pas largimit të tyre nga qendra, punonjësit e qendrave i vizitojnë ato në banesat e tyre dhe komunikojnë vazhdimisht me to, duke i asistuar në kapërcimin e problemeve të shumta që hasin pas daljes nga qendra.

G. Përkujdesje për fëmijët e viktimave të trafikimit:

Qendrat japin kujdes jo vetëm për viktimat e trafikimit, por edhe për fëmijët e tyre. Qendra ofron për këta fëmijë: strehim, kujdes shëndetësor dhe edukim.

3. Mekanizmi Kombëtar i Referimit (MKR) dhe Baza e të Dhënave për viktimat e trafikimit

Zyra e Koordinatorit Kombëtar dhe IOM kanë bashkëpunuar për procesin e hartimit, konsultimit dhe lançimit të *Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave të Trafikimit*. Drafti i parë u hartua gjatë periudhës janar – mars 2010. Në muajin prill u organizua workshop-i konsultues me aktorët kryesore në vend. Në këtë proces konsultues u përfshinë më shumë se 50 përfaqësues nga DPPSH, MPJ, MPÇSSH, PP, Koalicioni i Qendrave dhe përfaqësues të tjerë aktivë në fushë. Mendimet dhe sugjerimet e derivuara nga ky takim u reflektuan në dokumentin e përmirësuar.

Në muajin korrik 2010 u organizua një workshop tjetër i cili bëri të mundur konsolidimin e dokumentit me inputet e një numri më të gjerë aktorësh. Në 21 Tetor 2010 u lançua dokumenti, i cili bëri të mundur dhe hapjen e fazës së pilotimit. Gjatë muajit nëntor u zhvilluan disa takime rajonale në qarqet Lezhë, Kukës, Gjirokastrë dhe Elbasan, që përfshinë përfaqësues nga qarqet e afërta, duke u mbuluar kështu të 12 qarqet e vendit. Në këto takime, ekspertë të fushës së ndjekjes penale, mbrojtjes, parandalimit dhe koordinimit dhanë këshillat dhe ekspertizën e tyre në implementimin sa më të mirë të këtij dokumenti. Gjatë muajit dhjetor 2010, një grup monitorues për këtë qëllim bëri të mundur monitorimin e implementimit të dokumentit, si dhe nevojat praktike për ndryshim. Monitorimet u kryen në Korçë, Kukës, Sarandë, Gjirokastrë, Durrës dhe Tiranë. Aktualisht, ZKKA po reflekton ndryshimet e nevojshme në dokument¹⁸. Ky dokument do të miratohet zyrtarisht brenda majit 2011.

Gjatë periudhës së raportimit të gjithë aktorët e MKR-së janë përpjekur të përmbushin përgjegjësitë dhe detyrat e tyre. Në qendrat rezidenciale, **ka patur 97 referime**. Moshë mesatare e viktimave të trafikimit është **15-25 vjeç**, pothuajse të gjitha rastet vijnë nga familje me probleme të theksuara social-ekonomike, prindër të divorcuar, mungesa të theksuara ekonomike, familje me probleme shëndetësore, braktisje apo keqtrajtim.

Autoriteti Përgjegjës¹⁹, gjatë periudhës së raportimit, ka qenë aktiv në plotësimin e detyrimeve të tij për identifikimin, asistimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit. AP është mbledhur në mënyrë periodike, të paktën një herë në muaj. Gjithashtu, që prej vitit të kaluar Ministri i Brendshëm ka organizuar takime mujore me anëtarët e Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe aktorë të tjerë partnerë.

Ka vazhduar hedhja e të dhënave në bazën e të dhënave për viktimat e trafikimit. ZKKA po punon për të përmirësuar dhe lehtësuar hedhjen e të dhënave në sistem dhe po punon për përmirësimin e mënyrës së analizimit të të dhënave.

18 Raportin për monitorimin e pilotimit të zbatimit të *Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave të Trafikimit* do ta gjeni në Aneks .

19 URDHËR I PËRBASHKËT “Për Ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave të Trafikimit dhe Përcaktimin e Detyrave të Institucioneve të Përfshira në këtë Proces” Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme Nr. Prot 3394/4, datë 17. 05. 2006 Nr. prot. 7590, datë 24. 05 2006.

4 . Identifikimi dhe referimi i viktimave të trafikimit

Një nga sfidat më të vështira në procesin e mbrojtjes dhe asistencës ndaj viktimave të trafikimit është identifikimi i viktimave të trafikimit, procesi i verifikimit të personave që mund të jenë apo janë viktimat trafikuari - do të thotë gjetja e viktimave të trafikimit. Vetëm nëse kryhet identifikimi i një viktime trafikuari bëhet e mundur dhënia e ndihmës dhe mbrojtjes ndaj viktimës dhe ndëshkimi i shfrytëzuesve të saj. Autoritetet shqiptare po punojnë për t'u aftësuar në zbulimin e gjithë formave të trafikimit: trafikim për punë të detyruar; trafikim për qëllim shfrytëzim prostitucioni; trafikim i të miturve; punë e detyruar; lypje. Për këtë qëllim shërbejnë Procedurat Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Personave të Trafikuar mbi të cilën po punon ZKKA mbështetur nga IOM. Procedurat standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit kanë filluar të aplikohen në të gjithë qarqet e vendit; ZKKA po vazhdon të përmirësojë direktivat dhe udhëzimet e këtij dokumenti në përputhje me nevojat dhe sfidat që procesi ka. Qendra "Vatra" raporton se, gjatë këtij muaji, janë referuar, në përputhje me këto procedura, dy viktimat të mundshme të trafikimit.

Në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit, një viktimë trafikuari mund të identifikohet brenda territorit shqiptar, në kufi ose jashtë territorit shqiptar. Viktimat mund të jenë shqiptare apo të huaja, në moshë madhore apo minorene. Procesin e identifikimit ka *dy faza*: Identifikimi fillestar dhe identifikim formal. Gjatë periudhës së raportimit nuk është identifikuar asnjë viktimë trafikuari e huaj, megjithatë legjislacioni shqiptar siguron ruajtjen e qëndrimit të tyre ligjor për rimëkëmbje dhe reflektim. Kjo është një siguri që e përfitojnë të gjithë personat e trafikuar, pavarësisht nga vullneti i tyre për të dëshmuar.

a. Rritja e kapaciteteve për aktorët që kryejnë identifikimin fillestar²⁰ dhe formal²¹ të një viktime trafikuari

Më parë identifikoheshin si faktorë pengesë për rritjen e numrit të identifikimeve mungesa e burimeve njerëzore dhe kapaciteteve për të kryer intervistimin dhe për të hetuar rastet. Për të kapërcyer këtë shqetësim, me ndryshimet e fundit strukturore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, është rritur numri i personelit të Sektorëve të Luftës kundër Trafikëve të Paligjshme në Drejtorinë e Policive në qarqe (*Shih Kapitullin 1 "Ndjekja Penale dhe Hetimi"*). Përveç rritjes së kapaciteteve burimore në numër, gjatë periudhës së raportimit, është punuar shumë për trajnimin e vazhdueshëm të personelit të strukturave antitrafik dhe të Shërbimit Social Shtetëror. Gjatë vitit 2010, me mbështetje nga IOM, u organizuan cikle trajnimesh për ngritjen e kapaciteteve profesionale të *administratorëve shoqërorë* në strukturat e pushtetit vendor (Bashki/Qark), të punonjësit social të *Zyrave Rajonale të Shërbimeve Sociale*, për punonjësit e *Njësitëve për Mbrojtjen e Fëmijëve* në bashki/komunë. Qëllimi ishte njohja e këtyre strukturave me legjislacionin në fuqi, me strategjitë kombëtare të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, me institucionet dhe mekanizmat e ngritur, me masat e marra nga qeveria shqiptare, me detyrimet që kanë struktura të veçanta për identifikimin, intervistimin, asistimin, mbrojtjen dhe ri-integrimin e VeT.

Gjatë këtij viti, strukturat e Policisë së Shtetit kanë bashkëpunuar në mënyrë efektive. Në Pikat e Kalimit Kufitar është zbatuar me rigorozitet, "Plani i Veprimit", nr. 3316 datë 10.06.2008, "*Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe identifikimin e viktimave*", dhe

20 Procesi i identifikimit tek një person i elementeve të sjelljes dhe gjendjes së tij fizike, mendore, sociale dhe ekonomike që tregojnë se ky person mund të jetë viktimë e trafikimit, dhënia e ndihmës ndaj personit, njoftimi i autoriteteve përgjegjëse dhe bashkërendimi e bashkëpunimi me struktura qeveritare dhe jo qeveritare për ndihmën e mbrojtjen e personit në përputhje me nevojat e tij/saj.

21 Procesi i identifikimit të elementeve të krimit të trafikimit të kryer ndaj personit, nëpërmjet intervistimit formal të personit nga një oficer i policisë gjyqësore të SLKTP, vlerësimi i nevojave të personit për siguri dhe mbrojtje dhe bashkërendimi e bashkëpunimi me struktura qeveritare dhe joqeveritare për ndihmën e mbrojtjen e personit në përputhje me nevojat e tij/saj.

Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 871 datë 27.12.2007 “Për Procedurat që Duhet të Kryhen për Intervistimin e Shtetasve të Huaj dhe Shqiptarë të Kthyer nga Vendet e Tjera”, duke rritur bashkëpunimin me specialistët e Seksioneve të Trafikeve në Drejtoritë e Policive në Qarqe, me qëllim që, në rastet e shtetasve të kthyer ne P.K.K, intervistimi të kryhet sa më objektiv dhe të bëhet identifikimi i viktimave të trafikut.

Edhe strehëzat që ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit raportojnë se bashkëpunimi i tyre me DPPSH ka sjellë referime të rasteve në këto strehëza. Qendra “Tjetër Vizion” raporton se, si rezultat i një marrëveshjeje të Shoqatës “Tjetër Vizion” me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, është bërë i mundur referimi dhe asistimi i rasteve me shtrirje gjeografike të gjerë, duke përfshirë jo vetëm Shqipërinë qendrore por dhe raste të referuara nga jugu dhe veriu i Shqipërisë. Referimi i rasteve është bërë dhe në kuadër të bashkëpunimit si Koalicion i Strehëzave Antitrafik dhe i ndihmës reciproke në raste të transferimit nga njëra strehëz në tjetrën për arsye sigurie apo ri-integrimi.

IOM në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta/ Shërbimi Social Shtetëror ka zhvilluar disa sesione trajnimesh “Mbi ngritjen e kapaciteteve për çështjet e trafikimit të fëmijëve” me punonjës të strukturave sociale lokale (administratorë social) në Lushnjë dhe Lezhë, të patrajnuar më parë mbi këto çështje. Qëllimi i këtyre trajnimeve është të informojë administratorët socialë në bashki me njohuri dhe aftësi të cilat do të bëjnë të mundur dhënien e asistencës për viktimat e trafikimit dhe bashkëpunimit me struktura të tjera. Në sesionin e Lushnjës morën pjesë 33 pjesëmarrës nga Fieri, Berati, Lushnja, Vlora etj. dhe në atë të Lezhës morën pjesë 23 pjesëmarrës nga Lezha, Shkodra, Durrësi, Tirana dhe Laçi.

b. Rritja e kapaciteteve për aktorët që mund të kryejnë identifikimin fillestar të një viktime trafikimi

Deri më sot, është punuar shumë për të siguruar trajnimin e strukturave të zbatimit të ligjit dhe punonjësve të shërbimit social mbi mënyrat se si identifikohet një viktimë trafikimi. Synimi i ZKKA është të rrisë kapacitetet identifikuese jo vetëm në strukturat direkte që merren me këtë proces, por edhe tek strukturat të cilat kanë probabilitetin më të lartë për t’u ndeshur me një viktimë trafikim, viktimë të mundshme trafikimi apo persona në rrezik trafikimi si: Inspektorati i Punës; shkollat, zyrat e asistencës për punë e ndihmë ekonomike, klinika shëndetësore, organizata të ndryshme që punojnë me fëmijët apo të rinjtë, prindër. Për të përmbushur këtë qëllim, ZKKA, në bashkëpunim me partnerët e saj, do të planifikojë trajnime, të cilat do të synojnë informimin e këtyre aktorëve mbi mënyrat se si ata mund të ndihmojnë në identifikimin e një personi, i cili mund të jetë në rrezik trafikimi apo brenda rrjetit të trafikimit, mënyrat se si mund të referohen këto raste etj. *Përfshirja e aktorëve të sipërpërmendur luan një rol të rëndësishëm në identifikim, sidomos të rasteve të trafikimit të brendshëm.*

4.1 Identifikimi brenda territorit të vendit

Agjencitë kanë përmirësuar identifikimin e rasteve të trafikimit brenda vendit. Ky përmirësim ka ardhur si rezultat i trajnimeve të vazhdueshme të organizuara nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe partnerëve të saj. Policia e Shtetit ka identifikuar 3 raste të trafikimit të brendshëm.

4.2 Identifikimi në kufi

Shqipëria tashmë ofron siguri të plotë në kufijtë e saj, siguri kjo që përputhet me standardet evropiane. Çdo shtetas që hyn apo del nëpërmjet kufirit shtetëror evidentohet në sistemin TIMS. Për fëmijët zbatohen procedura strikte kur ato udhëtojnë me njërin nga prindërit ose me persona të tjerë. Për këto raste kërkohet deklarata noteriale e prindërve që e lejon fëmijën të udhëtojë me njërin nga prindërit ose personat e tjerë. Është kryer lidhja e sistemit TIMS në 24 Pikat e Kalimit

Kufitar, në tre Komisariate të Policisë së Kufirit dhe Migracionit dhe në tetë Drejtori Rajonale të Kufirit dhe Migracionit. Gjithashtu, është lidhur sistemi MEMEX në të gjitha Drejtoritë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit.

Komiteti Rajonal Kukës informon se, në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë Qarkut, Drejtorinë e Policisë Kufirit e Migracionit, në përmbushje të marrëveshjes me IOM nga ALB-AID, është asistuar në të gjitha rastet sipas kërkesës së strukturave të specializuara. Asistenca e ALB-AID ka qenë në përmbushjen e nevojave imediate të personave të deportuar me ushqime e mjete sanitare, praninë e punonjësit social dhe transportin nga Morina për në Kukës e deri në Tiranë. Po nga Zyra Rajonale e SH.S.SH Kukës, nëpërmjet administratorëve, janë marrë kontakte me organizmat jo-qeveritare për organizimin e bashkëveprimit të tyre me strukturat e specializuara të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Gjatë këtij viti, IOM Tirana ka asistuar në kthimin e asistuar të 6 rasteve të viktimave shqiptare të trafikimit të identifikuar në Kosovë dhe të referuara nga IOM Prishtina. Procesi i kthimit u koordinua nga zyrat respektive të IOM. IOM Tirana në bashkëpunim me Autoritetin Përgjegjës dhe ZKKA koordinuan kthimin e rasteve në vend.

a. Statistika dhe trajnime

Gjatë vitit 2010 është synuar trajnimi i personelit kufitar mbi praktikat më të mira të zbulimit dhe parandalimit të trafikimit dhe për zbatimin e konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare përkatëse të nënshkruara dhe ratifikuara nga Republika e Shqipërisë që kanë të bëjnë me fëmijët viktime. Si rezultat, është kryer trajnimi i personelit të Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit në Tiranë, Durrës, Korçë, Gjirokastrë dhe Kukës. Janë trajnuar në këto Drejtori rreth **80 oficerë**. Trajnimet janë organizuar nga ZKKA në bashkëpunim me IOM.

b. Prania e oficerëve femra dhe punonjësit social në kufi

Gjithashtu, Policia e Shtetit ka bërë të mundur sigurimin e pranisë së **të paktën një oficerëve anti-trafik femër në kufi** gjatë identifikimit fillestar/intervistimit, sipas detyrimeve të Marrëveshjes së Mekanizmit Kombëtar të Referimit. Prezenca është siguruar në pikat e kalimit kufitar: Hani i Hotit, Qafë Morinë, Qafë Thanë, Tushemisht, Kapshticë, Tre Urat, Kakavijë, Qafë Botë, Sarandë, Vlorë, Durrës dhe Rinas. Gjithashtu, edhe një punonjës i Shërbimit Social Shtetëror apo punonjës social nga qendrat rezidenciale jopublike duhet të jetë prezent gjatë identifikimit fillestar/intervistimit të një viktime potenciale të trafikimit. Edhe ky detyrim është plotësuar si nga ana e SHSSH dhe nga ana e punonjësve social të qendrave rezidenciale jo-publike.

c. Bashkëpunimi kufitar me homologët

Drejtoritë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit kanë rritur bashkëpunim me homologët e tyre respektivë. Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit, Qarku Dibër, raporton se një herë në dy javë bën takime me policinë maqedonase për problemet e hasura, si dhe, vazhdimisht, kryejnë patrullime të përbashkëta. Komiteti Rajonal Antitrafik- Kukës konstaton se të kthyerit deportiv nga Kosova i përkasin, në një pjesë të konsiderueshme, komunitetit rom, të cilët kryesisht lypin në rrugët e Kosovës. Për të identifikuar rastet apo për t'i parandaluar ato, KRAT-Kukës raporton se është bashkërenduar në vazhdimësi me Drejtorinë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit Kukës e Shërbimit Policor Kosovar për marrjen e masave parandaluese për kalimin e paligjshëm të kufirit. Për këtë qëllim, janë zhvilluar takime periodike mujore me shërbimet policore kosovare për shkëmbime informacioni.

Komiteti Rajonal Kukës thekson se, për të kthyerit deportiv, destinacioni i tyre ka qenë Kosova për punë të ndryshme dhe një pjesë e konsiderueshme i përkasin komunitetit rom, të cilët kryesisht lypin në rrugët e Kosovës. Për identifikimin e parandalimin e fenomenit të trafikimit është bashkërenduar në vazhdimësi me Drejtorinë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit Kukës e Shërbimit Policor Kosovar, për të marrë masa në parandalimin e kalimeve ilegale të kufirit. Për këtë qëllim, janë zhvilluar takime periodike mujore me shërbimet policore analoge, për

shkëmbime informacioni për individë e grupe kriminale, me aktivitete të paligjshme në drejtim të trafikimit të qenieve njerëzore. Gjithashtu, edhe Komiteti Rajonal Shkodër raporton se është rritur bashkëpunimi me strukturat homologe të Malit të Zi në parandalimin e trafikimit.

4.3 Identifikimi jashtë vendit

Trafikimi i qenieve njerëzore është një fenomen që ka ekzistuar në këto 20 vite të fundit. Si rrjedhojë, qytetarë shqiptarë, femra apo meshkuj, në moshë madhore apo minorene, nga zonat urbane apo rurale kanë rënë pre e rrjeteve të trafikimit në njerëz, në të shumtën e rasteve të trafikimit transnacional. Është detyrim i shtetit shqiptar që t'i gjejë këto viktime, t'i identifikojë si të tilla dhe t'u japë të gjithë ndihmën dhe mbrojtjen e nevojshme. Për këtë qëllim, ka shumë rëndësi se si qeveria shqiptare i përqaset identifikimit jashtë vendit. Një rol thelbësor luajnë përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit dhe marrëdhëniet që ato krijojnë me agjencitë shqiptare, por dhe me ato të huaja të përqendruara tek identifikimi, referimi, mbrojtja dhe asistenca ndaj viktimeve të trafikimit. *Ministria e Punëve të Jashtme ka raportuar se, gjatë vitit 2010, janë dhënë udhëzimet përkatëse me qarkore në ambasada dhe konsullata për mbajtjen e një regjistri të veçantë dhe informimi i rregullt pranë Autoritetet Përgjegjës për çdo rast potencial trafikimi.* Ambasadat dhe konsullatat janë informuar gjerësisht për bashkëpunimin që duhet të institucionalizojnë me autoritetet e vendit pritës dhe me shoqatat joqeveritare, për ndërgjegjësimin e viktimeve të trafikuar për kthimin vullnetar të tyre në Shqipëri, si dhe për ndihmën që ato duhet t'u japin me dokumentacionin e nevojshëm për këtë qëllim.

Gjithashtu, *MPJ ka hartuar së fundmi një manual konsullor me udhëzime të përgjithshme për detyrat e konsujve jashtë shtetit (përfshi dhe ato që lidhen me problemet e luftës kundër këtij trafikimi).* Ambasadat dhe konsullatat shqiptare janë të udhëzuara që të mbajnë lidhje me median e shkruar dhe televizive në vendin pritës, me grupet dhe shoqatat e shqiptarëve dhe atyre të huaja dhe, nëpërmjet tyre, të përhapin informacion dhe materiale të kësaj natyre. Një objektiv i veçantë për MPJ, gjatë kësaj kohe, ka qenë edhe sigurimi i një shpërndarjeje të gjerë të informacionit/materialeve (broshura) për viktimat e mundshme shqiptare jashtë shtetit. Për këtë qëllim, ambasadat dhe konsullatat janë udhëzuar që të mbajnë lidhje me median e shkruar dhe televizive në vendin pritës dhe me grupet e shoqatave të shqiptarëve.

Në datën 12 nëntor 2010, me kërkesën e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, MPJ u dërgoi gjithë përfaqësive diplomatike dhe konsullore shqiptare dhe të huaja, kopje të fletëpalosjes së hartuar nga ky Koordinator për ndërgjegjësimin e publikut për çështje të Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Me këtë rast, Titullarëve të Përfaqësive u janë dhënë udhëzime të qarta për angazhimin serioz të personelit të kualifikuar me shërbimet ndaj qytetarëve, për të bashkëpunuar për identifikimin, trajtimin dhe referimin e viktimeve të trafikimit. Përfaqësitë janë porositur për mënyrën se si duhet punuar me këtë fletëpalosje, qoftë në ambientet e tyre, qoftë dhe në rrethet e shoqatave dhe organizatave joqeveritare që veprojnë në ato vende.

5. Mbrojtja e viktimeve dëshmitare

Në zbatim të ligjit nr. 10173, datë 22.10.2009 "Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë", masat e posaçme të mbrojtjes zbatohen ndaj personave që bashkëpunojnë me organet e drejtësisë ose bashkëpunëtorët e drejtësisë. Kategoritë e personave të mbrojtur janë: dëshmitar drejtësie, bashkëpunëtor drejtësie, persona të lidhur me dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë. Masat e posaçme të mbrojtjes që zbatohen ndaj personave të mbrojtur janë: ndryshimi i vendbanimit, dhënia e dokumenteve të rreme, mbrojtja dhe trajtimi i posaçëm në rastet kur, për kryerjen e një veprë penale, bashkëpunëtorit të drejtësisë i është caktuar masë sigurimi ose është dënuar me burgim, mbrojtja fizike dhe teknike në vendin ku qëndron personi si dhe gjatë lëvizjeve të tij, rehabilitimi social, dhënia e ndihmës financiare. Përveç zbatimit të masave të lartpërmendura, personave të marrë në mbrojtje iu ofrohet: arsimim, kontroll mjekësor, ndihmë e specializuar ligjore, mbështetje dhe trajtim psikologjik. Gjatë vitit 2010, buxheti i miratuar i ka mbuluar të gjitha shpenzimet e nevojshme dhe të domosdoshme për

zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes. Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Personave të Veçantë ka nënshkruar dhe po zbaton disa marrëveshje bashkëpunimi ndërkombëtar me objekt “rilokimin e personave të marrë në mbrojtje jashtë territorit të vendit”.

Me qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të kësaj drejtorie me Departamentin e Trajnimeve të DPPSH dhe organizmave ndërkombëtare, janë zhvilluar një sërë trajnimesh brenda dhe jashtë vendit.

Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Personave të Veçantë raporton se në zbatim të nenit 28 të ligjit të lartpërmendur, janë hartuar dhe miratuar aktet nënligjore, 3 Udhëzime të përbashkëta dhe 2 Urdhra të përbashkët.

Bashkëpunimi me viktimat e trafikimit dhe programin për mbrojtjen e dëshmitarit:

Viktimat e trafikimit kanë shfaqur gatishmëri për të dhënë shpjegime sa herë që është parë e nevojshme ripyetja e tyre për të sqaruar rrethana të caktuar të hetimit. Gatishmëria e viktimave për të mbështetur prokurorinë është krijuar për shkak të bindjes që është formuar tek to se janë marrë masat mbrojtëse të duhura dhe efektive.

Deri më tani, nuk figurojnë raste të përfshirjes së viktimave së trafikimit në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve në zbatim të Ligjit, që garanton mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Në praktikën e deritanishme, nuk janë regjistruar raste të përfshirjes së viktimave në programin e mbrojtjes, pasi nuk janë plotësuar kushtet e vendosjes në mbrojtje (neni 10 i ligjit). Sipas ligjit, kushtet e vendosjes në mbrojtje konsistojnë në krijimin e një situatë, ku viktimat e trafikimit, për shkak të deklarimeve a dëshmisë, ndodhet në gjendje rreziku. Gjendja e rrezikut duhet të jetë aktuale, konkrete dhe serioze, për shkak të së cilës jeta dhe shëndeti i dëshmitarit apo personit të lidhur me të janë në rrezik.

REKOMANDIME:

- Të mbulohet trajtimi shëndetësor falas i viktimave të trafikimit.
- Të forcohet dhe të institucionalizohet bashkëpunimi i strehëzave me drejtoritë dhe zyrat lokale.
- Të sigurohet mbështetje e vazhdueshme financiare për qendrat jo-publike.
- Të ruhet një nivel i lartë bashkëpunimi dhe komunikimi mes anëtarëve të MKR-së nëpërmjet takimeve periodike, shkëmbimit të informacionit dhe transparencës.
- Të rriten kapacitetet e aktorëve që kryejnë identifikimin fillestar dhe formal të një viktime trafikimi.

Parandalimi

Parandalimi i trafikimit është një prej shtyllave ku vëmendja në 2010 ka qenë edhe më e madhe. Kjo edhe për faktin se tashmë Shqipëria ka bërë mjaft përpara në dy drejtimet e tjera, ndjekjen penale dhe mbrojtjen e viktimave dhe situata aktuale në vend dikton një punë më intensive dhe të mirorientuar të të gjithë aktorëve në drejtim të parandalimit të trafikimit të njerëzve.

Fokusi i veprimtarisë parandaluese në periudhën janar – dhjetor 2010, ka qenë kryesisht në rritjen e ndërgjegjësimit publik për shkaqet dhe rrezikun ndaj trafikimit, nëpërmjet:

- organizimit të fushatave të ndërgjegjësimit që synojnë të arrijnë publikun e gjerë në përgjithësi, grupet në rrezik, klientët dhe shfrytëzuesit e mundshëm, si edhe të gjithë aktorët që punojnë me grupet në rrezik përfshi, median,
- përmirësimit të përfshirjes sociale të grupeve në nevojë,
- ofrimit të alternativave ekonomike ndaj trafikimit, përfshi migracionin e sigurt etj.

Për këto dhe për zhvillimet më të fundit në lidhje me përpjekjet e bëra gjatë periudhës në fjalë në drejtim të parandalimit të trafikimit në Shqipëri, do të mund të gjeni një informacion të bollshëm në sesionet vijuese.

1. Plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor

Në drejtim të arsimit të rinjve dhe të fëmijëve, sidomos nga komunitete të marginalizuara si ai Rom dhe Ballkano-Egjiptian, nëpërmjet iniciativës së MASH, janë miratuar disa vendime të qeverisë, të cilat mundësojnë përfshirjen e anëtarëve të këtyre komuniteteve në sistemin arsimor. Kështu, me VKM nr. 586, datë 07.07.2010 “Për Kuotat e Pranimi dhe Tarifat e Shkollimit në Institucionet Publike të Republikës së Shqipërisë”, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, si dhe për tarifën e shkollimit për vitin akademik 2010-2011 për komunitetin Rom dhe Ballkano-Egjiptian janë planifikuar 25 kuota pranimi. Gjithashtu, me VKM nr. 795, datë 06.10.2010 “Për Kuotat e Pranimi në Institucionet Publike të Republikës së Shqipërisë, cikli i dytë i studimeve “Master Profesional”, për vitin akademik 2010-2011 për këto komunitete janë planifikuar 20 kuota, ndërsa, me VKM nr. 786, datë 29.9.2010 “Për Kuotat e Pranimi në Institucionet Publike të Republikës së Shqipërisë, cikli i dytë i studimeve “Master i Shkencave”, për vitin akademik 2010-2011 janë planifikuar 20 kuota. Më tej, me VKM nr. 826, datë 13.10.2010 “Për Kuotat e Pranimi në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë dhe Tarifat e Shkollimit për Studimet e Ciklit të Parë me Kohë të Pjesëme, dhe Edukimit në Distançë në Vitin Akademik 2010-2011” për Romët dhe Ballkano-Egjiptianët janë planifikuar 20 kuota. Po sipas këtij vendimi përjashtohen nga tarifën e shkollimit aplikantët Rom dhe Ballkano-Egjiptianë që fitojnë të drejtën për të studiuar në një program studimi të ciklit të parë me kohë të pjesëme. Këtë të drejtë e kanë edhe studentët Rom dhe Ballkano-Egjiptianë të viteve më të larta. Më tej, në zbatim të udhëzimit nr. 15, datë 28.05.2010 për shitjen e tekstit në arsimin parauniversitar, nxënësit që gëzojnë statusin ligjor të jetimit, nxënësit që vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie nga zyrat e punësimit, që vijnë nga familje që kanë në përbërjen e tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, kur kryefamiljari përfiton pension invaliditeti apo pension pleqërie, përfitojnë mbështetje buxhetore për kompensimin e çmimit të teksteve shkollore.

Në lidhje me identifikimin e shtetasve nëpërmjet përmirësimit të regjistrimit civil, më datë 27 prill 2010 u hartua dhe miratua Urdhri i Ministrit të Brendshëm Nr. 141, datë 27.04.2010 “Për Referimin dhe Regjistrimin e Aktit të Lindjes të Personave që Figurojnë të Peregjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile”. Në zbatim të këtij urdhri nëpërmjet bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, gjatë vitit 2010, është bërë i mundur regjistrimi i 70 lindjeve që paraqiteshin problematike për regjistrim, ndërsa në 2009 numri i regjistrimeve të peregjistruarve ishte 7000. Koordinatori Kombëtar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile po punojnë për identifikimin, referimin dhe zgjidhjen e rasteve të pakta të peregjistruara në Regjistrin e Gjendjes Civile.

Ndërsa, në tetor 2010 u miratua edhe Udhëzimi Nr. 359, datë 11. 10. 2010 i Ministrit të Brendshëm “Për Procedurat e Pastrimit të Dublimeve të Shtetasve Shqiptarë nga Regjistrat Themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile”, i cili përcakton procedurat për pastrimin e shtetasve të dubluar, si dhe për identifikimin e shtetasve me të dhëna fiktive.

Për sa i përket mbrojtjes së fëmijëve nga të gjitha format e shfrytëzimit, kuadri i brendshëm ligjor është plotësuar me Ligjin kuadër Nr. 10 347, datë 04.11.2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”. Po kështu, Koordinatori Kombëtar, në bashkëpunim me UNICEF dhe Sektorin e të Miturve dhe Dhunës në Familje në DPPSH, kanë paraqitur propozime të mëtejshme për përmirësimin e Kodit Penal, sidomos në nenet që ndëshkojnë keqtrajtimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve, për të plotësuar dhe përmirësuar më tej kuadrin ligjor për mbrojtjen e fëmijëve dhe respektimin e të drejtave të tyre, çka do të ndikojë drejtpërdrejt në parandalimin e fenomenit të shfrytëzimit të fëmijëve për qëllime të paligjshme.

2. Rritja e ndërgjegjësimit publik

2.1. Fushata ndërgjegjësuere

Me rastin e Ditës Botërore kundër Punës së Fëmijëve gjatë periudhës 1 qershor – 30 qershor 2010 me mbështetjen e ILO-IPEC u zhvillua një fushatë e re e titulluar: “*Shko drejt Qëllimit: Fund Punës së Fëmijëve*”. Qëllimi i kësaj fushate ishte rritja e ndërgjegjësimit mbi format më të këqija të punës së fëmijëve dhe trafikimit, shkaqet dhe pasojat e punës dhe shfrytëzimit të fëmijëve. Kjo fushatë u mbështet nga ILO/IPEC dhe u organizua nga MPÇSSHB në bashkëpunim të ngushtë me Federatën Sindikale të Arsimit dhe Shkencës në Shqipëri (TUFESA) dhe median. Materialet që u përdoren për fushatë ishin: njoftim për shtyp, artikuj në gazetat kryesore dhe revista, debate publike në kanalet televizive dhe radio, si edhe shpërndarja e materialeve për eliminimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve 2010 si plani i veprimit dhe gjetjet kryesore të Raportit Global të Punës së fëmijëve. Aktivitetet e organizuara me rastin e kësaj dite synonin:

- rritjen e ndërgjegjësimit për ndikimet negative të punës së fëmijës tek fëmija dhe tek e ardhmja e vendit.
- advokim për rritjen e mbështetjes qeveritare në fushën e arsimit dhe shërbimeve sociale.
- ndërtimin e kapaciteteve të sindikatave për të monitoruar më mirë zbatimin e marrëveshjes së përbashkët për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve.
- forcimin e ndërgjegjësimit dhe partneritetit ndër të gjithë aktorët e përfshirë në trajtimin e punës së fëmijëve dhe nxitjen e arsimimit.

Po në qershor 2010 u adoptua me prioritete të rishikuara edhe Udhërrëfyeni Kombëtar për Shqipërinë në përputhje me Udhërrëfyenin e adoptuar nga Konferenca Globale për Punën e Fëmijëve.

Me rastin e Ditës Evropiane kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Njerëzve në 18 tetor 2010 në bashkëpunim me Karitasin Shqiptar dhe Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, zhvilloi konferencën me temë: “*Trafikimi në njerëz shkatërron jetë dhe dëmton shoqërinë....Së bashku mund ta luftojmë atë!!!*” Ky aktivitet u zhvillua në ambientet e Universitetit “Zonja e Këshillit të Mirë”, ku krahas mesazheve të përcjella nga përfaqësues të autoriteteve shtetërore dhe organizatave jofitimprurëse aktive në fushën e antitrafikimit, u përcollën mesazhe ndërgjegjësuere edhe nga vetë nxënësit e shkollave të fillore dhe të mesme të Tiranës dhe zonave periferike të saj drejtuar bashkëmoshatarëve të tyre.

ZKKA më 22 nëntor 2010, në bashkëpunim me UNICEF, Qendrën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri, World Vision dhe Alo 116 organizoi një workshop me temë “ Ta bëjmë internetin të sigurt për fëmijët”, ku të ftuar ishin përfaqësues të agjencive shtetërore si MB, DPPSH, MPÇSSHB, MASH, si dhe AKEP, AKSHI, media etj. Qëllim i këtij workshopi ishte ndërgjegjësimi i strukturave shtetërore dhe joshtetërore për bërjen e internetit të sigurt për fëmijët nëpërmjet përmirësimit të legjislacionit kombëtar, forcimit të mekanizmave institucionalë mbrojtës dhe parandalues, si dhe ndërgjegjësimit të fëmijëve dhe prindërve për rreziqet dhe problemet që ndeshin fëmijët në komunikimet elektronike.

Me rastin e Ditës Botërore për të Drejtat e Njeriut, ZKKA, fokusuar kryesisht tek të drejtat e fëmijëve, në bashkëpunim edhe me organizatën e fëmijëve World Vision organizoi një ekspozitë me foto të përgatitura nga 8 fëmijë të grup-moshave të ndryshme nga grupe të marginalizuara. Kjo ekspozitë u organizua në dt. 10 dhjetor 2010 në ambientet e Muzeut Kombëtar dhe u shfaq nga të gjitha televizionet kombëtare të vendit.

Krahas fushatave dhe aktiviteteve të tjera sensibilizuese, një tjetër mjet ndërgjegjësimi kanë qenë edhe **fletëpalosjet** e përgatitura për qytetarët dhe viktimat/viktimat e mundshme. Kështu, ZKKA ka përgatitur **6000 fletëpalosje** për sensibilizimin e shtetasve në lidhje me trafikimin duke patur në fokus të veçantë viktimat/viktimat e mundshme dhe të gjitha shërbimet në dispozicion të tyre. Po kështu, në këto fletëpalosje janë afishuar numrat e të gjitha qendrave pritëse dhe riintegruese, si edhe numri i gjelbër 0800 12 12. Këto fletëpalosje janë shpërndarë në çdo PKK, në ambasadat dhe konsullatat shqiptare jashtë vendit, si dhe në përfaqësitë e huaja diplomatike të atashuara në Shqipëri. Botimi i këtyre fletëpalosjeve u mundësua nga World Vision. Edhe Koalicioni i Strehëzave përgatiti disa broshura dhe fletëpalosje për shërbimet që qendrat pritëse dhe rehabilituese ofrojnë në Shqipëri, të cilat në bashkëpunim me Departamentin për Kufirin dhe Migracionin u shpërndanë nëpër pikat kryesore të kalimit kufitar.

Sa i përket ndërgjegjësimit në nivel lokal, vlejné të përmenden të mëposhtmet:

- **Në qarkun Dibër**, në kuadër të fushatës globale kundër dhunës ndaj grave nën moton “*Të njohim dhe mbrojmë të drejtat tona*”, në 7 dhjetor 2010 në bashkëpunim me qendrën AGRITA-Vizion u organizuan disa aktivitete sensibilizuese. Për 10 ditë televizionet lokale kanë shfaqur spote sensibilizuese për dhunën në familje. Po kështu, në mbështetje të grave në aspektin profesional është organizuar një fushatë ndërgjegjësimi për zhvillimin e turizmit malor, si dhe trajnime. Trajnimet janë organizuar me mbështetjen e OXFAM dhe synonin përkrahjen dhe asistencën teknike ndaj grave për paraqitjen në treg të produkteve të bëra prej tyre, si dhe për mënyrat e përgatitjes së grave për tregun.
- **Në qarkun Durrës**, Seksioni kundër Trafikeve të Paligjshme në bashkëpunim me Sektorin e Rendit në Polici dhe shoqatat lokale ka organizuar takime në disa shkolla të mesme dhe 9- vjeçare të qytetit të Durrësit, në Sukth dhe Shijak për informimin e të rinjve, sensibilizimin e tyre ndaj rrezikut të trafikimit, si edhe mbi pasojat e trafikimit në shoqëri. Po kështu, Drejtoria e Shëndetit Publik Durrës ka punuar për ndërgjegjësimin, informimin e grave dhe fëmijëve për të drejtat e tyre, veçanërisht për të drejtën për shërbim shëndetësor. Për këtë është zhvilluar edhe një tryezë e rrumbullaket me temë “Përmirësimi i jetesës së fëmijëve me HIV/AIDS dhe të prekur nga HIV/AIDS” në kuadër të rritjes së kapaciteteve të komuniteteve lokale, mbështetur nga UNICEF.
- **Në qarkun Korçë**, më 17 tetor 2010 me rastin e Ditës Ndërkombëtare kundër Urisë u shpërndanë ndihma ushqimore në familjet me probleme sociale, si dhe për fëmijët jetimë. Në fushatën kundër dhunës në familje të organizuar nga data 25 nëntor - 10 dhjetor, KRAT Korçë ka ndihmuar në organizimin e shumë aktivitete ndërgjegjësuese, ku ndër të tjera janë bërë prezent edhe fenomene negative të tilla si dhuna, e cila i hap rrugë trafikimit të personave të dhunuar. Po kështu, me rastin e festave të fundvitit u shpërndanë pako ushqimore, si dhe lodra për fëmijët me probleme sociale. Nga ana tjetër, fondacioni “Kenedi” çdo javë ka organizuar takime me gra, të cilat informohen dhe këshillohen për pasojat negative të trafikimit të njerëzve.
- **Në qarkun Vlorë** janë zhvilluar **32 sesione informuese me të rinj të shkollave të mesme** të Komunave Shushicë, Novoselë, Levan dhe Bashkisë Roskovec, ku **morën pjesë 374 nxënës** (nga 300 të parashikuar në projekt); **12 sesione informuese** në Komunitat Shushicë, Novoselë dhe Levan, ku **morën pjesë 134 gra dhe vajza të komunitetit rom** (nga 60 të parashikuar në projekt); 1 seminar në Bashkinë e Roskovecit të Rrethit të Fierit me temë “Bashkëpunimi shkollë-shoqëri –familje, faktor i rëndësishëm për edukimin e brezit të ri”; 1 bisedë në radio me temë “Krimi dhe dhuna në shoqërinë e sotme shqiptare” e realizuar në një prej radiove lokale të qytetit; dhe publikimi i fletëpalosjes me temë “Stop drogës! Ndrysho jetën tënde!” e realizuar në 1000 kopje. Gjatë sesioneve informuese me të rinjtë e shkollave të mesme dhe gratë dhe vajzat e komunitetit rom dhe atij në tërësi, janë trajtuar tema të tilla si: “Diskriminimi dhe paragjykimet midis komuniteteve me etni të ndryshme”, “Marrëdhëniet prindër-fëmijë-shkollë faktor i rëndësishëm për edukimin e brezit të ri” etj. dhe janë shpërndarë fletëpalosje dhe materiale të tjera sensibilizuese.

2.2. Trajnime me median

Duke u nisur nga roli i rëndësishëm i medias në parandalimin e trafikimit nëpërmjet shfaqjes së emisioneve sensibilizuese, debateve të ndryshme televizive dhe radiofonike apo pasqyrimin të aktiviteteve apo veprimtarive të organizuara në këtë fushë, **IOM ka organizuar 2 seminare trajnimi me gazetarë** në lidhje me çështjen e raportimit të rasteve të trafikimit. Këto seminare u organizuan **në bashkëpunim me ZKKA dhe Institutin Shqiptar të Medias**. Në seminarin e parë në datat **27-28 maj 2010, i cili** fokusohej tek media elektronike, morën pjesë 16 gazetarë, ndërsa tek i dyti, që fokusohej tek media e shkruar, morën pjesë 15 gazetarë, të cilët mbulojnë rubrikat sociale në gazetatat kryesore si: Gazeta Shqiptare, Panorama, Shekulli, Shqip, Telegraf, Korrieri, Koha Jonë, Albania, etj. si edhe në televizionet me shikueshmëri më të lartë si: Top Channel, Klan, Vizion Plus, News 24, Ora News, Koha TV etj.

Vetëm gjatë 6-mujorit të parë të 2010 u trajnuan **31 gazetarë** dhe redaktorë të medias së shkruar dhe asaj elektronike nga rrethet mbi raportimin e çështjeve të trafikimit të qenieve njerëzore dhe dhunës në familje, si dhe **32 gazetarë** dhe redaktorë u trajnuan për të drejtat e migrantëve. Këto trajnime synonin përmirësimin e aftësive raportuese dhe kreativitetin e gazetarëve. Dy seminare të ngjashme trajnimi me gazetarë nga rrethet (**32 pjesëmarrës**) u organizuan me fonde të “Austrian Development Agency” (ADA) në datat **16-17 shtator 2010**. Synimi kryesor i këtyre trajnimeve ishte rritja e ndërgjegjësimit ndaj misionit të gazetarëve për raportimin e duhur të përpjekjeve antitrafik si një detyrim ndaj publikut. Në të gjitha këto trajnime Koordinatori Kombëtar ka qenë trajneri kryesor. Gjithashtu, në datat 21-22 shtator 2010 u organizua trajnimi i gazetarëve të medias së shkruar dhe asaj elektronike për rritjen e ndërgjegjësimit mbi mënyrën e duhur të mbulimit në shtyp të çështjeve të migracionit.

3. Përmirësimi i kapaciteteve të aktorëve që punojnë me kategoritë vulnerabël

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), në bashkëpunim me ZKKA, ka organizuar seanca trajnimi për përmirësimin e kapaciteteve të strukturave vendore të shërbimit social shtetëror, duke përfshirë edhe administratorët shoqërorë mbi çështjet e trafikimit. Këto trajnime u organizuan në qarkun Lushnjë dhe Lezhë në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror dhe Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Njëra prej seancave të trajnimit u organizua në Lushnjë ku morën pjesë **33 pjesëmarrës** nga bashkia Fier, Berat, Lushnjë dhe Vlorë dhe zyrat rajonale të SHSSH, ndërsa seanca tjetër u zhvillua në Lezhë ku morën pjesë **23 pjesëmarrës** nga Lezha, Shkodra, Durrësi, Tirana dhe Laçi. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte pajisja e punonjësve socialë dhe administratorëve shoqërorë nga bashkitë e përzgjedhura me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të asistuar me profesionalizëm viktimat e trafikimit nëpërmjet bashkëpunimit të frytshëm midis strukturave shtetërore dhe ofruesve të shërbimeve.

Po në drejtim të përmirësimit të kapaciteteve të strukturave shtetërore, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës në datat 18 qershor 2010 dhe 29 tetor 2010 u organizuan edhe dy trajnime mbi çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore me gjyqtarë dhe prokurorë. Qëllimi i përgjithshëm i këtyre trajnimeve ishte rritja e ndjeshmërisë së magjistratëve shqiptarë mbi çështjen e trafikimit. Pjesëmarrësit ishin gjyqtarë të shkallës së parë dhe prokurorë nga rrethet Berat, Sarandë, Mat, Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, etj. Në këto trajnime u trajnuan **gjithsej 30 prokurorë dhe gjyqtarë**.

Ndërsa, për sa i përket përmirësimit të kapaciteteve të përfaqësuesve tanë diplomatikë, gjatë 6-mujorit të dytë të 2010, MPJ ka punuar për realizimin e një projekti të përbashkët me IOM në Tiranë. Konkretisht, është punuar për realizimin e trajnimit të **20 punonjësve konsullorë** të

përfaqësive shqiptare diplomatike jashtë vendit. Për këtë qëllim, janë zhvilluar takime ndërmjet përfaqësuesve të MB, MPJ dhe IOM për krijimin e një ekipi nga MPJ, MB dhe IOM për trajnimin e konsujve pranë përfaqësive diplomatike dhe konsullore në rajon. Gjatë 2010, është bërë rregullisht, informimi dhe ndërgjegjësimi i konsujve, për të bërë një punë cilësore gjatë intervistimit të shtetasve të huaj për marrjen e vizave, me qëllimin për të bërë të mundur identifikimin e personave të dyshuar që mund të jenë viktime të trafikimit ose të implikuar në këtë drejtim.

4. Punësimi

4.1. Programet aktive të tregut të punës/ Programet e nxitjes së punësimit

Gjatë vitit 2010 i është dhënë përparësi programeve të nxitjes së punësimit. Këto programe hartohen në përputhje me Ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për Ndihmën Shtetërore”. Është punuar për hartimin e akteve nënligjore për programe të reja të nxitjes së punësimit, bazuar në Programin e Qeverisë. Konkretisht, është planifikuar të hartohet një vendim i ri për nxitjen e punësimit të të rinjve.

Në bashkëpunim me projektin “Fuqizimi i shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional në Shërbimin Kombëtar të Punësimit” financuar nga Qeveria Italiane dhe që zbatohet nga ILO është hartuar metodologjia e kryerjes së vlerësimit dhe monitorimit të programeve të nxitjes së punësimit. Janë përpiluar udhëzimet për hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve aktive të tregut të punës për persona që rrezikojnë të përjashtohen nga tregu i punës, si dhe është realizuar trajnimi i specialistëve përkatës. Për procesin e monitorimit janë parashikuar dhe fondet përkatëse nga buxheti i shtetit.

Gjatë kësaj periudhe i është kushtuar një rëndësi e veçantë organizimit të panairove të punës, të cilët janë organizuar nga Zyrat e Punësimit në bashkëpunim të ngushtë me Dhomat e Tregtisë, komunitetin e biznesit, universitetet, etj. Panairët kanë shërbyer për vendosjen e lidhjeve ndërmjet ofertave dhe kërkesave të tregut të punës dhe futjen në tregun e punës sidomos të të rinjve të diplomuar.

Për vitin 2010, nga buxheti i shtetit janë akorduar 150 milion lekë për programet e nxitjes së punësimit, të cilat po zbatohen nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit, nëpërmjet Zyrave të Punësimit, në katër programet ekzistuese si më poshtë:

- **Programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë femra** (në zbatim të VKM Nr. 632, datë 18.09.2003 i ndryshuar). Për këtë program, në vitin 2010, janë shpenzuar **21 milion lekë për vazhdimin e punësimit të 407 grave**. (Programi është në vitin e tretë të zbatimit);
- **Programi i nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë** (në zbatim të VKM nr. 47, datë 16.01.2008). Nëpërmjet këtij programi janë punësuar **700 punëkërkuës të papunë**, nga të cilët **500 janë femra, me një fond prej 59 milion lekësh;**
- **Programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë, në vështirësi** (në zbatim të VKM nr. 48, datë 16.01.2008). Aktualisht, numri i përfituesve nga ky program është punësuar **401 punëkërkuës të papunë, me një fond prej 20 milion lekësh;**
- **Programi i praktikave profesionale për punëkërkuësit e papunë që kanë mbaruar arsimin e lartë brenda apo jashtë vendit** (në zbatim të VKM Nr. 873, datë 27.12.2006). Gjatë 2010 nëpërmjet këtij programi janë punësuar **480 punëkërkuës të papunë**, studentë të cilët kanë mbaruar arsimin e lartë me një **fond prej 28 milion lekësh**.

Gjatë 2010 **në total, numri i punëkërkuësve të punësuar** nëpërmjet programeve të lartpërmendura është gjithsej **1988**.

Me kontributin e Projektit “Punësimi dhe Migrimi i të Rinjve”, financuar nga qeveria spanjolle dhe në bashkëpunim me INSTAT, po punohet për përmirësimin e statistikave të tregut të punës.

Programet pasive/Pagesa e papunësisë

Në gusht 2010 u miratua VKM Nr. 697, datë 18.08.2010 “Për Caktimin e Nivelit Bazë të së Ardhurës nga Papunësia”, e cila është në përputhje me angazhimet e marra në kuadër të Konventës Ndërkombëtare të ILO-s Nr. 168 “Nxitja e punësimit dhe mbrojtja kundër papunësisë”, e cila është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë. Në nenin 14 të kësaj Konvente parashikohet që e ardhura nga papunësia duhet të jetë jo më e ulët se 50% e pagës minimale në shkallë vendi. Shuma aktuale e të ardhurës nga papunësia është 6.565 lekë në krahasim me 6.340 lekë që ka qenë më parë.

Për vitin 2010 (Janar – Nëntor) janë regjistruar pranë zyrave të punësimit **73 105** punëkërkuese të **papuna femra**, nga të cilat **41** punëkërkuese të papuna janë **femrave të trafikuar** në qytetet Vlorë dhe Tiranë, të cilat përfitojnë shërbime ndërmjetësimi për punësim, orientim për formim profesional, si dhe shërbime të tjera të ofruara nga punonjëset e zyrave të punësimit.

4.2. Formimi Profesional (grupet e veçanta)

Janë nxjerrë evidencat analitike dhe sintetike për formimin profesional për kurset e formimit profesional të ofruara nga qendrat publike. Për këtë periudhë, rezultojnë në total për të gjitha qendrat rreth 7.000 persona të regjistruar, nga të cilët rreth 5.600 persona janë certifikuar. Nga këto 3.004 janë femra, ndërsa punëkërkuet të papunë të regjistruar në zyrat e punësimit që kanë ndjekur kurse të profesioneve kanë qenë 1.450 persona nga të cilët janë punësuar pas formimit 444 persona. Është shqyrtuar dokumentacioni përkatës për subjektet që kanë aplikuar për t'u licensuar si ofrues të formimit profesional. Gjatë periudhës së raportimit janë licensuar si ofrues të formimit profesional, rreth 180 subjekte, që kanë aplikuar pranë QKL-së.

Për periudhën janar – tetor 2010 në shkallë vendi kanë përfituar trajnim pranë DRFPP-ve **3610 femra** në kurse të ndryshme të profesioneve. Nga grupet e veçanta, ku përfshihen edhe viktimat e trafikimit, kanë përfituar formim profesional **796 punëkërkuet të papunë femra**, nga të cilat **562** femra me tarifë të reduktuar dhe **169** femra janë punëkërkuese të papuna me tarifë falas. Nga grupi i **femrave të trafikuar** kanë përfituar **formim profesional falas** për këtë periudhë **26 punëkërkuese të papuna**, në qytetet Tiranë, Durrës dhe Vlorë.

Ndërsa në disa qarqe, pjesëmarrja në kurset e formimit profesional është mundësuar në bashkëpunim edhe me agjencitë joshtetërore. Kështu, në qarkun **Lezhë 129 persona** nga grupmosha të ndryshme kanë marrë pjesë **në 11 kurse** të formimit profesional. Pas një kursi formimi 1 (një) mujor nga 23 gra të intervistuar, 17 kanë fituar për t'u vetëpunësuar. Ndërsa në qarkun **Korçë** në Zyrën Rajonale të Punës janë regjistruar **9 fëmijë** kryesisht djem për kurse mobilierie dhe hotelerie dhe **35 gra** punëkërkuese të **papuna nga komuniteti rom dhe egjiptian**. Po kështu, kjo zyrë ka mbështetur **27 persona** kryesisht **gra kryefamiljare**, si dhe **100** punëkërkuet **të papunë** me qëllim përfshirjen e tyre në kurse profesionale. Ndërsa, nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional dhe Kryqi i Kuq, Dega Korçë janë zhvilluar kurse për formim profesional **për 10 gra rome e egjiptiane**.

Aktualisht, MPÇSShB po punon për miratimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8872, datë 29.03.2002 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”. Ky projektligj është hartuar nga një grup pune i përbashkët i MPÇSShB dhe MASH, dhe është mbështetur me ekspertizë të huaj nga ana e Projektit “Mbështetje për reformën në fushën e AFP” Faza II, që është financuar nga BE në kuadrin e Programit CARDS.

5.Arsimi

Arsimi i grupeve vulnerabël, sidomos i fëmijëve dhe të rinjve ka qenë një drejtim tjetër ku është fokusuar parandalimi gjatë vitit 2010. Nëse do t'i hidhnim një vështrim masave të marra gjatë vitit të raportimit sipas kategorive përfituese, mund të themi se përpjekjet janë fokusuar kryesisht në:

- uljen e braktisjes shkollore (Programi “Shansi i Dytë”);
- arsimimin e pakicave etnike; dhe
- arsimimin e fëmijëve të ngjuar.

5.1. Vazhdimi i përpjekjeve për rritjen e pjesëmarrjes në arsimin e detyrueshëm/uljen e braktisjes shkollore

Vazhdon zbatimi dhe monitorimi i **Programit “Shansi i Dytë”** për të gjithë fëmijët që kanë braktisur shkollën. Për vitin shkollor 2009-2010, projekti shtrihet në **29 shkolla të vendit**, ku funksionojnë **62 klasa, që frekuentohen nga 513 fëmijë** të moshës së detyrimit shkollor, **nga të cilët 310 fëmijë ose 60.4% e tyre janë rom.**

Po kështu, të gjitha DAR dhe ZA kanë organizuar trajnime me mësues që punojnë me nxënës që kanë braktisur shkollën dhe që kanë tendenca braktisjeje. Mësuesit punojnë me programe të veçanta pune me qëllim që të sensibilizojnë prindërit për rëndësinë e shkollimit. Në çdo DAR/ZA është ngarkuar një specialist që merret me problemet e arsimimit të shtresave të marginalizuara me qëllim zbutjen e fenomenit të analfabetizmit dhe braktisjes shkollore.

Konkretisht, në qarkun **Lezhë** në kuadrin e **Programit “Shansi i Dytë”** janë organizuar **19 klasa të veçanta me 172 nxënës**. Numri i fëmijëve **rom** të regjistruar në këto klasa është **70 ose 30%** i numrit total të nxënësve. Ndjekja e klasave të posaçme është mundësuar në bashkëpunim me shoqatën e “Marianistëve” në qendrën rinore “Shën Nikolla”. Kjo shoqatë, gjithashtu, ka pajisur me mjete mësimore si çanta shkolle, mjete didaktike 70 nxënësit rom, ndërsa familjeve të tyre iu është dhënë një pagesë prej 3000 lekë dhe ushqime për çdo fëmijë.

Në qarkun Dibër, Drejtoria Arsimore Rajonale (DAR) Dibër, ka treguar kujdes të veçantë në tërheqjen e nxënësve në institucionet e edukimit. Në zbatim edhe të objektivave të përcaktuara nga MASH për “Braktisjen zero”, është hartuar një plan veprimi, realizimi i të cilit është ndjekur nga kjo drejtori çdo muaj. Në vitin 2010 është konstatuar një ulje e ndjeshme e numrit të nxënësve nën 16 vjeç që nuk frekuentojnë shkollën. Sipas raportimeve, **numri i nxënësve që kanë braktisur shkollën** dhe që kjo drejtori i sheh si kontingjent të mundshëm trafikimi është **gjithsej 109 nga të cilët 75 femra**, kurse 9 fëmijë janë jashtë sistemit shkollor. Në bashkëpunim me strukturat e shkollave dhe organizatën World Vision, kjo drejtori arsimore ka arritur të kthejë në shkollë 7 fëmijë të moshës 13-14 vjeç.

Në qarkun Korçë, nga bashkia Korçë janë evidentuar 103 fëmijë nga 4 shkolla periferike të qytetit me probleme sociale. Këtyre fëmijëve iu janë shpërndarë libra falas për ciklin 9-vjeçar, komplete me mjete shkollore, si dhe veshje të ndryshme për t'i ndihmuar ata të ndjekin rregullisht shkollën. Në sajë të punës bashkëvepruese të aktorëve të Tryezës Teknike të KRAT Korçë, 15 fëmijë në situatë rruge u rikthyen në muajin shtator në shkollë, duke u futur në klasa speciale të mundësuar nga fondacioni “Ndihmë për Fëmijët”.

Në qarkun Vlorë, janë regjistruar për të vazhduar shkollën me korrespondencë 10 përfitues të akomoduar në strehëz, përkatësisht:

- 2 përfituese në klasën e parë fillore;
- 1 përfituese në klasën e tretë fillore;
- 1 përfituese në klasën e shtatë të formimit 9-vjeçar;
- 2 përfituese në klasën e gjashtë të formimit 9-vjeçar;
- 3 përfituese në shkollën e mesme;

5.2. Arsimimi i pakicave etnike

Në zbatim të planin të veprimit “Dekada e Përfshirjes së Romëve” gjatë vitit 2010 DAR/ZA me qëllim arsimimin e pakicave etnike dhe lehtësimin e kushteve të këtij komuniteti për t’u arsimuar:

- kanë përgatitur një program vjetor për ndjekjen me përparësi të problemeve të realizimit të arsimimit të fëmijëve rom;
- në bashkëpunim edhe me drejtoritë e shkollave, pushtetin vendor dhe me komunitetin rom, kanë punuar për përgatitjen dhe plotësimin e statistikave që do të sigurojnë të dhëna për arsimimin e komunitetit rom;
- në bashkëpunim me drejtoritë e shkollave, pushtetin vendor dhe komunitetin rom, po punojnë për të evidentuar numrin dhe vendndodhjen e fëmijëve rom në moshë shkolle, duke saktësuar sa prej tyre nuk vazhdojnë shkollën (mosha dhe klasa që kanë kryer). Në këtë mënyrë, do të mundësohet identifikimi i numrit të saktë të fëmijëve rom të moshës 3-5 vjeç, duke u pasuar nga masat për regjistrimin e tyre në arsimin parashkollor, duke iu dhënë përparësi fëmijëve të grupit të tretë.

Në bashkëpunim me Institutin e Zhvillimit të Arsimit (IZhA), janë planifikuar dhe po organizohen trajnime të mësuesve rreth mësimdhënies/mësimnxënies në mjedis shumëkulturor të integruar. Specialistët e IZhA, në bashkëpunim me UNICEF dhe Save the Children kanë kryer trajnimet e mësuesve në çështje, të tilla si: historia dhe kultura rome; metodologjitë e përdorura për gjithëpërfshirjen e nxënësve dhe fëmijëve rom në klasë; hapësirat kurrikulare për trajtimin e çështjes me fokus romët etj. Vetëm gjatë vitit 2010, janë trajnuar 456 mësues.

Po në këtë kuadër, nga **DAR Shkodër** gjatë 2010 janë marrë masa konkrete për parandalimin e trafikimit të fëmijëve dhe konkretisht konstatohet se **ka një rënie të ndjeshme të numrit të fëmijëve që braktisin shkollën**. Ka projekte konkrete për aktivizimin e **komunitetit Rom** në shkolla, ku numri i tyre si nxënës vetëm në këto dy vitet e fundit është rritur në rreth **100 nxënës**.

Ndërsa, në **qarkun Gjirokastrë** në kuadër të Dekadës së Përfshirjes së Romëve janë dhënë detyra për përfshirjen e anëtarëve të këtij komuniteti në skemat e ndihmës sociale duke iu dhënë atyre informacion të herëpashershëm. Njëkohësisht, janë evidentuar 47 nxënës rom, të cilët ndjekin arsimin 9-vjeçar.

5.3. Arsimi i fëmijëve të ngjuar

Arsimimi i nxënësve të ngjuar vazhdon të kryhet sipas **Udhëzimit për Arsimimin e Nxënësve të Ngjuar për Shkak të Gjakmarrjes**. Të gjithë fëmijëve që kanë shkollën mbi 2 km larg nga vendbanimi i përhershëm u ofrohet **shërbimi i transportit (16500 nxënës gjithsej përfitojnë nga ky shërbim)**.

DAR Dibër ka mundësuar shërbimin e transportit të nxënësve nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas duke vendosur **12 linja transporti, që u shërbejnë 750 nxënësve**.

Në zbatim të vendimit për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe studentëve në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2009-2010 iu është dhënë përparësi për dhënie burse nxënësve nga shtesa sociale në nevojë.

5.4 Ndërgjegjësimi i fëmijëve në sistemin shkollor

Gjatë vitit 2010, ka vazhduar puna për ndërgjegjësimin e fëmijëve dhe të rinjve në shkolla në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore, dhunën në familje, edukimin pozitiv etj. Kurrikula shkollore e arsimit parashkollor 9-vjeçar dhe e klasës 10 dhe 11 të arsimit të mesëm, lejon trajtimin e tematikave të veçanta me nxënësit dhe kjo ka mundësuar përfshirjen e informacionit për të drejtat e fëmijëve dhe sigurinë e tyre në shkollë dhe jashtë saj, si edhe për tema të tjera të lira siç është

edhe trafikimi i qenieve njerëzore. Kjo linjë ndiqet nëpërmjet lëndës:

- “Edukimi shoqëror dhe qytetar”, e cila fillon që në klasën e parë dhe vijon deri në klasën e pestë të ciklit fillor. Këtu trajtohen kategoritë e të drejtave të fëmijëve që bazohen thellësisht në Konventën e të Drejtave të Fëmijës;
- “Edukatë qytetare” në klasën e VI – IX, e cila ka përsëri një linjë kurrikulare më vete për të drejtat e njeriut, ku trajtohen këto të drejta në marrëdhënie me grupin, me komunitetin, si dhe me edukimin e fëmijëve për të jetuar në një shoqëri demokratike dhe globale;
- “Njohuri për shoqërinë” në klasën e III të shkollës së mesme në profilin shoqëror. Qëllimi është formimi i një brezi të ri që njeh dhe respekton të drejtat e njeriut dhe të informuar mbi fenomenet negative për zhvillimin e duhur të tyre.

Për të konkretizuar më tej përpjekjet e strukturave shtetërore për parandalimin e trafikimit të fëmijëve, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës nënshkruan në janar 2011 një Marrëveshje Bashkëpunimi “Për edukimin e nxënësve të arsimit 9-vjeçar me njohuri mbi trafikimin e njerëzve”. Sipas kësaj marrëveshjeje, do të sigurohet integrimi i 2 (dy) orëve të detyrueshme në vit për trafikimin e njerëzve në kurrikulën e arsimit 9-vjeçar, si dhe trajnimi i mësuesve mbi trajtimin e këtyre temave.

5.5. Institucionalizimi i një sistemi të “mbrojtësve të fëmijëve” në shkolla

Tashmë që prej prillit të vitit 2008 është legjitimuar shtrirja e **shërbimit psikologjik** shkollor në arsimin parauniversitar, kopshte dhe shkolla. Pranë çdo shkolle ku funksionon SHPSH, në ndihmë të psikologut është ngritur grupi mbështetës i psikologut që përbëhet nga drejtori dhe dy mësues. Në nivel shkolle ky është grupi që trajton problemet e fëmijëve në rrezik trafikimi.

Aktualisht, janë **190 psikologë** gjithsej, të cilët mbulojnë **37 DAR/ZA**. Në zbatim të marrëveshjes ndërmjet MASH dhe TdH në 5 DAR të vendit po vazhdon zbatimi i projektit “*Përforcimi i rolit të shkollës në mbështetjen dhe mbrojtjen e fëmijëve brenda mjedisve të shkollës*”, i cili përfshin 160 shkolla 9-vjeçare. Ndërkohë është hartuar manuali për mbrojtjen e fëmijëve dhe po vijon zbatimi në shkollat e këtyre 5 DAR dhe më gjerë²².

Gjatë 6-mujorit të dytë të 2010, ka vazhduar puna me prindër dhe nxënës rom dhe jo rom për rritjen e njohurive dhe **mirëkuptimit midis fëmijëve rom dhe atyre jo rom**. Janë organizuar aktivitete sociale, ndërkulturore në **110 shkolla ku janë zhvilluar 370 aktivitete me rreth 5800 pjesëmarrës**.

Nga shembujt në terren, në qarkun e Dibrës, për të garantuar frekuentimin e përditshëm të shkollës, u është kërkuar të mbajnë kontakte të rregullta me prindërit, sidomos të atyre fëmijëve që mungojnë në shkollë pa leje. Një detyrë e veçantë për këtë i është vënë edhe psikologut të shkollës, i cili punon si me fëmijët edhe me prindërit e tyre. Në vitin 2010, numri i psikologëve të vendosur nëpër shkolla në këtë qark është rritur²³. Gjithsej, **në rrethin Dibër, shërbimi psikologjik ofrohet në 30 shkolla** duke mbuluar një numër të konsiderueshëm të nxënësve të shkollës.

22 Gjatë vitit 2010 janë zhvilluar:

- 170 seanca sensibilizuese me prindërit;
- 840 seanca sensibilizuese dhe këshilluese me nxënësit;
- 987 ID file janë hapur për fëmijët me probleme të mbrojtjes;
- 3 fëmijë janë referuar tek strukturat e tjera lokale si NjMF në bashki, qendra shëndetësore etj;
- 270 vizita janë kryer në familjet e fëmijëve me probleme. MASH po punon që përvojën e mirë të krijuar në këto shkolla ta shtrijë më tej.

23 Nga bashkëpunimi me shoqatën jofitimprurëse “Partnerë për Fëmijët” shërbimi psikologjik është shtrirë edhe në shkollat Luzni, Katund i Ri, Muhurr, Hurdhë, Sllovë, Ploshtan, Radomirë.

Është punuar sistematikisht për ofrimin e **këshillimit prindëror në shkolla dhe kopshte për prindërit rom**, rreth të drejtave dhe detyrimeve për zhvillimin arsimor të fëmijëve, si:

- janë trajnuar **294 mësues dhe specialistëve** për të këshilluar prindërit rom.
- nga 23 DAR/ZA, janë zhvilluar **103 fushata** ndërgjegjësuere me pjesëmarrjen e **995 prindërve rom**;
- janë trajnuar **230 mësues** në sesionet e mësimdhënies në një mjedis shumëkulturore;
- Është rritur pjesëmarrja e prindërve rom në bordet e shkollave. Aktualisht, prindërit rom marrin pjesë në **57 borde me 87 pjesëmarrës**.

Në vijimësi, MASH në bashkëpunim me UNICEF, po punon për lançimin e një plani kombëtar për reduktimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve si mjete disiplinimi, i cili synon, gjithashtu, shtimin e praktikave të reja, pozitive të disiplinimit, duke mënjanuar apo reduktuar format e dhunës në mjediset e shkollës. Po për këtë qëllim, një tjetër organizatë e njohur, si World Vision ka organizuar në qarkun e Dibrës trajnime me **59 mësues** nga shkollat e tre komunave të rrethit Dibër për futjen e metodave të reja të disiplinimit të fëmijëve dhe krijimin e një ambienti miqësor për to.²⁴

6. Institucionalizimi i mekanizmave të mbrojtjes parandaluese dhe përkrahjes në nivel vendor dhe rajonal për grupet në nevojë dhe në rrezik trafikimi, si dhe identifikimi dhe sigurimi i masave parandaluese për individët në nevojë.

6.1. Aktiviteti i Komiteteve Rajonale Antitrafik

Komitetet Rajonale Antitrafik janë mbledhur rregullisht dhe kanë vazhduar funksionimin e tyre bazuar edhe në udhëzimet e fundit të Ministrit të Brendshëm në 2010 për koordinimin e veprimit antitrafik në nivel qendror dhe lokal. Gjatë vitit 2010, vërehet një angazhim dhe koordinim më i mirë ndërmjet agjencive shtetërore të përfaqësuar në tryezën teknike dhe ndërmjet këtyre agjencive dhe OJF-ve dhe organizatave që veprojnë në qarqet respektive.

Në aspektin e parandalimit, ka vazhduar puna për identifikimin e shtresave në nevojë dhe referimin e tyre tek shërbimet përkatëse. Po kështu, janë zhvilluar takime tematike me gra dhe vajza nga zonat e varfra për ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me këtë fenomen, si edhe biseda televizive në televizionet lokale për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe dhunën në familje. Ka vazhduar sensibilizimi i komunitetit për masat që duhet të marrin për minimizimin e këtij fenomeni.

Organizatrat ndërkombëtare dhe ato jofitimprurëse që, ndër të tjera, punojnë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si ILO-IPEC, UNICEF, Save the Children, WV, TdH, NPF, etj., kanë qenë mbështetëse të rëndësishme të KRAT-ve në parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, në veçanti trafikimit të fëmijëve. Me mbështetjen e tyre, është bërë i mundur organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere me fëmijë për promovimin e të drejtave të tyre në komunitetin ku jetojnë. Gjithashtu, ato me projektet e tyre kanë vazhduar të mbështesin regjistrimin e fëmijëve në shkolla; edukimin e fëmijëve të ngujuar në kushtet e shtëpisë; formimin profesional të të rinjve, si dhe të vajzave dhe grave viktime të trafikimit.

Me gjithë punën e bërë nga Komitetet gjatë 2010, vërehet se mungesa e buxhetit me zëra specifikë për realizimin e detyrimeve të tyre vazhdon të jetë pengesa kryesore në përmbushjen si duhet të këtyre detyrimeve. Ky ka qenë edhe një prej shkaqeve kryesore të kufizimit të punës së komiteteve, kryesisht në ato aktivitete që nuk kërkojnë fonde të veçanta. Aktivitetet e tyre, sidomos aktivitetet ndërgjegjësuere, trajnimet apo mbështetja e shtresave në nevojë janë mundësuar kryesisht nëpërmjet mbështetjes së organizatave jofitimprurëse që veprojnë në këto qarqe.

24 Gjatë korrik-gusht 2010, me mbështetjen e WV, u mundësua dërgimi i 260 fëmijëve të moshës 5-13 vjeç në kampe verore në Lurë, ndërsa 400 fëmijë të tjerë u përfshinë në kampet ditore në komunat Kastriot, Tomina dhe Maqellarë, ku fëmijët, krahas argëtimit, u njohën edhe me të drejtat e tyre.

6.2. Përmirësimi i regjistrimit të lindjeve me anë të kombinimit të sistemeve nxitës e duke siguruar regjistrim falas për familje me të ardhura të ulëta, përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të shëndetësisë dhe Zyrës së Gjendjes Civile dhe bashkëpunimit të ngushtë me OJF-të e komuniteteve rome.

Që në muajt e parë të 2010-ës, me iniciativë të ZKKA, janë organizuar takime të përbashkëta ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe OJF-ve aktive në mbrojtjen e fëmijëve në rrezik apo të trafikuar, ndër të tjera, edhe për të lehtësuar procesin e regjistrimit të shtetasve “pa identitet”. Këto takime janë zhvilluar në mënyrë periodike çdo muaj. Në Prill 2010 u pa e nevojshme hartimi i një urdhri të Ministrit të Brendshëm për referimin dhe regjistrimin e aktit të lindjes së personave që figurojnë të paregjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Në **2010**, është bërë i mundur referimi i **24 rasteve të vjetra të paregjistruara; administrimi i 23 rasteve; ka filluar procedura e regjistrimit për 23 raste dhe vetëm 1 rast është kthyer për vërtetimin e aktit të lindjes në gjykatë**. Të gjitha rastet janë zgjidhur administrativisht dhe, vetëm aty ku kjo nuk ka qenë e mundur, është proceduar me zgjidhjen e çështjes nëpërmjet gjykatës.

Gjithashtu, po në drejtim të përmirësimit të regjistrimit, Ministria e Shëndetësisë, nëpërmjet strukturave të saj të vartësisë, raporton periodikisht listat e lindjeve tek Zyrrat e Gjendjes Civile.

7. Të tjera

7.1. Në fushën e mbrojtjes së fëmijëve nga shfrytëzimi për punë

Në fushën e mbrojtjes së fëmijëve nga puna, abuzimi dhe shfrytëzimi, ILO-IPEC, në bashkëpunim me MPÇSSHB, MASH, MB dhe institucionet në varësi të tyre, pushtetin vendor, partnerët socialë dhe OJF-të janë fokusuar në **forcimin e kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore në nivel qendror dhe lokal** për grumbullimin, analizimin e të dhënave, hartimin, rishikimin dhe zbatimin e ligjeve dhe politikave në fushën e mbrojtjes së fëmijëve nga puna, abuzimi dhe shfrytëzimi. Po kështu, me qëllim **institucionalizimin e modelit multidisiplinar të Sistemit të Mbrojtjes nga Puna e Fëmijëve nëpërmjet kuadrit ligjor**, në datat 11 – 12 nëntor 2010, ILO-IPEC, në bashkëpunim me MPÇSSHB/Drejtorinë e Politikave për Shanse të Barabarta dhe Familjen, organizuan trajnimin me temë “Puna e Fëmijëve, Format e Këqija të saj dhe Sistemi i Monitorimit të Punës së Fëmijëve”, ku u prezantua Draft – Udhërrëfyesi Shqiptar për eliminimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve.

Inspektorati Shtetëror i Punës (ISHP), gjatë vitit 2010, ka kryer **inspektime të vazhdueshme të subjekteve të ndryshme ku janë të punësuar fëmijë**. Gjatë periudhës janar-shtator 2010 ISHP ka evidentuar **297 fëmijë të moshës nën 18 vjeç**, ndërkohë që, në të njëjtën periudhë, në vitin 2009, kishte evidentuar 237 fëmijë në marrëdhënie pune. Shumica e fëmijëve të evidentuar janë **të moshës 17- vjeç**, përkatësisht **239 fëmijë**, duke vijuar me **42 fëmijë të moshës 16 vjeç**, **14 fëmijë të moshës 18 vjeç**, 1 fëmijë 15 vjeç dhe 1 fëmijë 14 vjeç. Për sa i përket seksit, **239 prej tyre janë femra dhe 58 meshkuj**. Në të shumtën e rasteve fëmijët janë **me arsim 9-vjeçar**, konkretisht **252 fëmijë**, **22 janë me arsim fillor**, **17 me arsim të mesëm të përgjithshëm** dhe **6 fëmijë pa arsim**.

Aktivitetet ku janë përqendruar këta fëmijë janë:

- Ndërmarrje prodhuese - 232 fëmijë
- Ndërtim - 4 fëmijë
- Transport, magazinim, telekomunikacion - 6 fëmijë
- Aktivitete të tjera - 3 fëmijë
- Tregti me shumicë dhe pakicë - 35 fëmijë
- Sipas nën - aktivitetit - 17 fëmijë

Nga numri total i fëmijëve të evidentuar, **256 janë të punësuar me autorizimin e ISHP-së, ndërsa 39 fëmijë pa autorizim**. **258 fëmijë** janë të evidentuar **me ekzaminim mjekësor**, ndërsa **39**

fëmijë pa ekzaminim mjekësor, kurse për sa i përket sigurimit shoqëror, **278 fëmijë rezultojnë të siguruar**, ndërsa **19 fëmijë të pasiguruar**.

Ndërsa në qarqe situata paraqitet si më poshtë:

Në qarkun Durrës, në muajin qershor 2010 me nismën e TdH dhe koordinimin e Institucionit të Prefektit dhe të Bashkisë Durrës, u organizua një tryezë e rrumbullakët mbi çështjen e mbrojtjes së fëmijëve, ku u miratua edhe një plan-veprimi i fokusuar tek fëmijët në situatë rruge. Plani i veprimit²⁵ synon adresimin dhe ndjekjen e nevojave të këtij grupi rast pas rasti.

Ndërsa, në muajin gusht 2010 në **Bashkinë Berat** u krijua “**Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve**”. Objekt i punës së kësaj njësie janë fëmijët dhe familjet në nevojë, krijimi i rrjetit mbështetës dhe këshillimi për këto kategori. Në qarkun Berat, ka vazhduar puna për identifikimin e fëmijëve të komunitetit rom dhe të dhënat mbi numrin e tyre sipas bashkive janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Vendbanimi	Popullsia	Fëmijë jetim	Braktisur Shkollën	Fëmijë të rrugës	Të papunë
Berat	455	28	45	27	132
Kuçovë	533	24	24	15	94
Urë Vajgurore	72	-	7	-	-
Otllak	1018	20	20	-	-
Qarku	2078	79	96	42	226

Në **Bashkinë Shkodër**, Zyra e Punës dhe e Çështjeve Sociale ka vendosur tashmë urat e bashkëpunimit me subjektet private për punësim një-vjeçar të kategorive të fëmijëve rom dhe të fëmijëve jetimë. Nëpërmjet një projekti 6-mujor për evidentimin e fëmijëve në rrezik, rom, si dhe të nënave të dhunuara, janë asistuar rreth 26 raste fëmijësh në nevojë, të cilat janë vulnerabël dhe një kategori në rrezik trafikimi. Këta fëmijë kanë marrë ndihmën dhe shërbimet e nevojshme nga sektorët përgjegjës në bashki.

7.2. Promovimi i Kodit të Sjelljes në Turizëm

Në kuadër të promovimit të mëtejshëm të Kodit Global të Etikës në Turizëm dhe Kodit të Sjelljes për industrinë turistike, si dhe sensibilizimit të anëtarëve të Shoqatës Shqiptare të Turizmit (ATA) MTKRS i ka pasqyruar këto kode në faqet zyrtare të saj www.mtkrs.gov.al dhe në faqen e internetit të ATA-s në zonën me përdorim të kufizuar për anëtarët. <http://ata.org.al/index.asp?id=469>. Gjithashtu, njoftimi dhe linku që hap këto dokumente është përfshirë në buletin e Qershorit të 2010 në një numër prej afro 570 lexuesish.

Ndërkohë, në projektligjin e ri “Për turizmin” që po përgatitet nga MTKRS, nëpërmjet akteve nënligjore përkatëse, do të përfshihet edhe zbatimi i Kodit Global të Etikës dhe Kodit të Sjelljes në standardet që duhet të plotësojnë njësitë akomoduese dhe agjencitë turistike të udhëtimit.

²⁵ Faza e parë e këtij plani konsistoi në punën sociale në rrugë për identifikimin e fëmijëve. Gjithashtu, për të tërhequr fëmijët nga rruga, TdH dhe Bashkia Durrës organizuan gjatë periudhës korrik-gusht një kamp veror për fëmijët e shfrytëzuar dhe në rrezik. Në këtë kamp veror, fillimisht ishte parashikuar të përfshiheshin 70 fëmijë, por gjatë zhvillimit të tij u ofruan shërbime për 150 fëmijë. Si pasojë e aktiviteteve integruese në këtë kamp, në shtator kanë filluar shkollën 40 fëmijë të shfrytëzuar.

7.3. Trajtimi i çështjeve që qëndrojnë në themel të trafikimit (përfshi varfërinë dhe papunësinë, diskriminimin e grave, pakicave, fëmijëve, migrantëve dhe grupet e tjera në nevojë)

Për sa i përket përfshirjes sociale të pakicave etnike, institucionet përgjegjëse shtetërore në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, kanë punuar për regjistrimin civil, arsimimin, rritjen e aftësive profesionale etj. Kështu, Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA), në zbatim të planit të veprimit “*Dekada e Përfshirjes së Romëve*”, gjatë periudhës qershor – gusht 2010, ka kryer studimin e plotë të nivelit të mësimdhënies, të përgatitjes dhe të kualifikimit të mësuesve që punojnë me fëmijë rom, si edhe rishikimin e përmbajtjes së kurrikulës shkollore për arsimin parauniversitar lidhur me trajtimet fyese e denigruese në programet dhe tekstet mësimore. Po në këtë kuadër, IZHA është duke hartuar një program trajnim-kualifikimi, si dhe kornizën e plotë me veprimtari, botime ndihmëse dhe module për ndjekjen me përparësi të problemeve të trajnim-kualifikimit dhe të trajtimit të mësuesve që punojnë me nxënës rom.

Në disa prej rretheve kryesore të vendit si Tiranë, Elbasan dhe Fier ka vazhduar mbështetja e komunitetit rom nëpërmjet zbatimit të projekteve të vogla të infrastrukturës, regjistrimit civil, kurseve profesionale, trajnimit të ndërmjetësve komunitarë, si dhe promovimit të përfshirjes sociale. Kjo është bërë e mundur nëpërmjet projektit të PNUD “*Për Fuqizimin e Komuniteteve në Nevojë*”, i cili ka si **përfitues direkt të tij më shumë se 1000 familje rome dhe egjiptiane që jetojnë në Tiranë, Fier dhe Elbasan** dhe është duke advokuar në bashkëpunim me pushtetin qendror dhe vendor, për përfshirjen sociale të minoriteteve në nevojë.

Gjithashtu, në ndihmë të emigrantëve të kthyer, është hartuar **Strategjia Kombëtare për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer në Vend dhe Plani i saj i Veprimit 2010-2015**. Këto dokumente u miratuan me VKM nr. 461, dt. 09.06.2010 dhe kanë për qëllim sigurimin e një kthimi të qëndrueshëm përmes lehtësimit të procesit të riintegrimin, duke synuar minimizimin e kostove të migracionit, maksimizimin e përfitimit dhe nxitjen e kontributit të emigrantëve për zhvillimin ekonomik të vendit. Mbështetur në këtë Strategji, është punuar për përmirësimin e kuadrit ligjor që kjo kategori të përfitojë nga zbatimi i politikave aktive të tregut të punës dhe shërbime të plota riintegruese.

Janë organizuar **dy trajnime me 84 punonjësit e sporteleve të migracionit për intervistimin, identifikimin e nevojave, dhënien e informacionit dhe referimin e shtetasve shqiptarë të kthyer**, ku janë përfshirë dy punonjës nga secili sportel migracioni.

8. Rekomandime

- Ndërgjegjësimi për trafikimin dhe shfrytëzimin për punë apo prostitucion të fëmijëve dhe të rriturve duhet të fokusohet edhe tek klientët.
- Vazhdimi i mëtejshëm i fushatave ndërgjegjësuere me përfshirjen e mediave dhe shkollave.
- Ulja e vulnerabilitetit të fëmijëve duke krijuar një ambient të përshtatshëm mbrojtës për ta.
- Ulja e braktisjes shkollore nëpërmjet promovimit të sistemeve nxitës; ndërgjegjësimi i stafit të mësuesve në shkolla për edukimin pozitiv të fëmijëve nëpërmjet trajnimeve dhe kualifikimeve të mëtejshme të mësuesve.
- Përgatitja e programeve edukative që theksojnë rëndësinë e barazisë gjinore dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

- Bërja efektive e programeve të nxitjes së punësimit për të rritur numrin e përfituesve nga kategoritë vulnerabël.
- Dhënia e fondeve për funksionimin dhe organizimin e veprimtarive të Komitetit Rajonal në mbështetje të viktimave të trafikimit.
- Planifikimi në buxhetet e bashkive dhe komunave i fondeve për ngritjen dhe funksionimin e qendrave të shërbimit social pranë tyre për shtresa të caktuara dhe për realizimin e veprimtarive në fushën antitrafik.
- Angazhimi i strukturave shtetërore për përkrahjen për punësim dhe përfshirjen sociale të fëmijëve jetim, të cilët përfundojnë arsimin e detyrueshëm dhe kërkojnë të punësohen.
- Identifikimi nëpërmjet regjistrimit civil i komunitetit rom dhe pakicave të tjera etnike.
- Trajnimi i mëtejshme i strukturave të policisë kufitare dhe migracionit dhe atyre antitrafik për identifikimin e rasteve të trafikimit të brendshëm.

ANEKS I – Trajnimet e zhvilluara me Policinë, Prokurorinë dhe Gjykatat me objekt Trafikimin e Qenieve Njerëzore

Trajnimet e zhvilluara sipas dateve dhe temave:

- Në zbatim të udhëzimit të përbashkët të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm të dt. 12.04.2010 “Për planifikimin, bashkërendimin, organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive trajnuese”, janë organizuar **tri trajnime** te përbashkëta, ku kanë marrë pjesë **75 punonjës policie** të strukturave antitrafik, policisë kufitare, parandalimit të krimit dhe dhunës në familje;
- Gjithashtu, në bashkëpunim me Departamentin për Trajnimin Policor janë organizuar **disa trajnime** me përfaqësues nga të gjitha strukturat antitrafik ku janë trajnuar rreth **54 punonjës policie**. Në këto trajnime janë trajtuar tema në lidhje me teknikat e hetimit, problemet e hasura gjatë hetimeve, intervistimi i viktimave të trafikimit si dhe referimi i tyre bazuar në Mekanizmin Kombëtar të Referimit;
- Policia e Kufirit dhe Migracionit në bashkëpunim me IOM, ZKKA dhe SKTPL kanë trajnuar **80 punonjës** të DRKM (Tiranë, Durrës, Korçë, Gjirokastër dhe Kukës) për përdorimin e sistemit TIMS dhe për procedurat e intervistimit të shtetasve që kthehen nga policitë e vendeve të tjera;
- Në bashkëpunim me IOM dhe Shërbimin Social Shtetëror (SHSSH), gjatë muajve shkurt – mars 2010 janë organizuar **trajnime të përbashkëta për strukturat e policisë antitrafik**, policisë kufitare, dhunës në familje dhe parandalimit të krimit për qarqet Kukës, Korçë, Sarandë dhe Gjirokastër, ku janë trajnuar **66 persona**;
- Në zbatim të Urdhrit Nr. 1/256, datë 09.03.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, u zhvillua **trajnimi me temë “Legjislacioni Procedural –Penal për të miturit. Teknikat e intervistimit të të miturit të dëmtuar nga aktiviteti kriminal”**. Trajnimi u zhvillua nga Qendra e Formimit Profesional dhe përfituesit ishin **25 punonjës policie** të strukturave për mbrojtjen e të miturve dhe dhunën në familje dhe ato të strukturave të parandalimit të krimit dhe policimit në komunitet;
- Në zbatim të Urdhrit Nr. 1/118, dat 09.03.2010 të Departamentit për Trajnimin Policor, janë zhvilluar trajnime me temë *“Trajtimi dhe mbrojtja e viktimave të dhunës në familje. Njohja*

me legjislacionin përkatës”. Trajnimet janë zhvilluar në Drejtoritë e Policisë së Qarkut Dibër, Kukës, Berat dhe Gjirokastrë, ku në çdo aktivitet kishte **20-25 punonjës policie** të strukturave për mbrojtjen e të miturve dhe dhunën në familje dhe ato të strukturave të parandalimit të krimit;

- Në kuadër të Projektit “*Promovimi dhe konsolidimi i drejtësisë restauruese*”, janë zhvilluar trajnime në DPQ Vlorë, Gjirokastrë dhe Korçë. Këto aktivitete u zhvilluan në partneritet me fondacionin “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”. Në këto trajnime u trajtuan tema lidhur me “*Rolin e Policisë në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, ku janë të përfshirë të mitur*”. Edhe në këto aktivitete (në secilin prej tyre) kanë përfituar nga **20-25 punonjës policie** të strukturave për mbrojtjen e të miturve dhe dhunën në familje dhe ato të strukturave të parandalimit të krimit;
- 11-12 janar 2010 dhe 14-15 janar 2010 – Trajnimi me temë “Ndhima ndaj viktimave dhe dëshmitarëve në proceset penale. Të drejtat dhe shërbimet ndaj viktimave dhe dëshmitarëve”. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë gjyqtarë, prokurorë, oficerë policie dhe student të Shkollës së Magjistraturës, në total 49 persona;
- 13-14 janar 2010 – Trajnimi me temë “Marrëdhëniet juridike me autoritetet e huaja. Njohje me aktet ndërkombëtare. Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në fushën civile”;
- 16-17 mars 2010 - Trajnimi me temë “Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve penale të huaja, ndikimi i konventave ndërkombëtare dhe marrëveshjeve dypalëshe. Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë. Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në fushën penale”;
- 29 – 30 mars 2010 - Trajnimi me temë “Letërporositë në gjykimin penal dhe aspekte të praktikës gjyqësore lidhur me vlerën e tyre provuese”;
- 13-14 prill 2010 - Trajnimi me temë “Aspekte teorike dhe praktike të krimit financiar, në përjasje me konventat ndërkombëtare. Pastrimi i produkteve të krimit dhe veprat penale në shoqëritë tregtare”;
- 13-14 prill 2010 – Trajnimi me temë “Çështjet që lidhen me parashikimet e ligjit Nr. 10193, datë 3.12.2009 “Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale”, si dhe implementimin e tij në praktikë nga hallkat e sistemit të drejtësisë” organizuar nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunimin me Këshillin e Europës dhe me mbështetjen e projektit PROSECO;
- 23 prill 2010 – Trajnimi me temë “Respektimi i të drejtave të viktimave në proces. E drejta për kompensim. Standardet ndërkombëtare dhe situata e legjislacionit dhe e praktikës në Shqipëri”. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë 11 gjyqtarë dhe prokurorë;
- 18 qershor 2010 – Trajnimi me temë “Aspekte teorike dhe praktike të trafikimit të qenieve njerëzore dhe praktika gjyqësore. Dhënia ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit. Aspekte teorike dhe praktike, në këndvështrimin e konventave ndërkombëtare”. Pjesëmarrës në këtë trajnim kanë qenë 18 gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe juristë;
- 20-21 tetor 2010 dhe 15-16 dhjetor 2010 – Trajnimi me temë “E drejta për kompensim dhe të drejta të tjera themelore të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në ligj dhe praktikë.”. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë rreth 35 persona.

Aneks II – Tabela me të dhëna për vitin 2010 për çështjet me objekt TQNJ të gjykuara nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda

N/R	Nr. aktit	Akuza (neni sipas KP)	Nr. i të pand.	Dt. e regj. në Gj Shk. I. Kr.R.	Nr. dhe dt. e Vendimit nga Gj. Shk. I .Kr.R	Masa e dënimit Vendimi Gj. Shk. I. Kr.R	Kohëzgj. e Gjykimit në Shkallë të parë
1	1	Traf. femr. 114/b-2	1	04.07.06	Vendim Nr.15 Dt. 23.04.2010	11 vjet + 4 mil L gj	3-4 vjet (gjykimi ka zgjatur për arsye procedurale)
2	16/50/24	Traf. femr. 128/b-2	1	14.11.08	Vendim Nr.2 Dt. 01.02.2010	15 vjet burgim	1 vit e 3 muaj
3	17/53	Traf. femr. 114/b-2	4	04.12.08	Vendim Nr.13 Dt.19.04.2010	10 vjet burgim 10 vjet burgim 10 vjet burgim 10 vjet burgim	1 vit e 4 muaj
4	18/53/139	Traf. femr. 114/b-2	1	19.12.08	=	=	Në gjykim
5	24/80/47	Traf. femr. 114/b-1 114/a-5	2	04.03.09	Vendim Nr.9 Dt.24.03.2010	7 vjet + 3 mil L gj. 7 vjet burgim	1 vit
6	27/91	Traf. femr. 114/b-3	1	28.05.09			Në gjykim
7	35/113	Traf. femr. 114/b-3	3	27.07.09	Vendim Nr.44 Dt.01.12.2010	10 vjet burg 10 vjet burg 9 vjet burg	1 vit e 2 muaj
8	46/129	Traf. femr. 114/b-3	1	26.11.09			Në gjykim
9	51/134	Traf. femr. 114/b-3	1	15.12.09	Dt. 29.03.2010	Kthimin e akteve Prokurorisë	4 muaj (Në hetim)
10	54	Traf. femr. 114/b-2	1	14.01.10	Vendim Nr.46 Dt.06.12.2010	Pafajesi	6 muaj
11	67	Traf. femr. 114/b-2	1	22.06.10			Në gjykim
12	78	Traf. femr. 114/b-3	1	20.09.10			Në gjykim
13	84	Traf. femr. 128/b-2	3	26.10.10			Në gjykim
14	93	Traf. femr. 114/b-3	1	06.12.10			Në gjykim
15	94	Traf. pers/ femr 114/a,b-1	1	07.12.10			Në gjykim
16	95	Traf. femr. 114/b-3	1	07.12.10			Në gjykim
17	97	1 - 109/1, 110/1	1	16.12.10			Në gjykim
18	107	Traf. femr. 128/b-3	1	30.12.10			Në gjykim
19	110	Shfr. Prost 114/a5,6	1	31.12.10		Për këtë çështje ka ndryshuar cil. jur. i v.p. nga 114/b në 114/a 5,6	Në gjykim
Totali	19		27				

Aneks III – Tabela me të dhëna për vitin 2010 për çështjet me objekt TQNJ të gjykuara nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda

Çështja sipas nenit të KP dhe dt. e regj. në Gj.Ap.Kr.R	Nr. dhe data e marrjes së Vendimit nga Gj.Ap.Kr.R	Nr. Pers. të den. sipas neneve në Shk.I.Kr.R	Masa e dënimit Vendim Shk.I.Kr.R	Vendimi Gj.Ap.Kr.R	Kohëzgj. e Gjykimit në Apel
Traf. i femr. 16.12.2009	Vend. Nr. 9 05.02.2010	2 - 114/b3	15 vjet + 6 mil. L gj. 15 vjet + 6 mil. L gj.	Lënie në fuqi e Vend. të Shk. I	2 - 3 muaj
Traf. i pers. 25.01.2010	Vend. Nr. 22 29.03.2010	1 - 110/a2	15 vjet	Lënie në fuqi e Vend. të Shk. I	2 - 3 muaj
Traf. i fëm. 05.03.2010	Vend. Nr. 33 21.06.2010	1 - 128/b2	15 vjet	Mospranim ankimi	2 - 3 muaj
Traf. i femr. 09.04.2010	Vend. Nr. 28 28.05.2010	1 - 114/b1 1 - 114/a5	7 vjet + 3 mil. L gj. 7 vjet	Lënie në fuqi e Vend. të Shk. I	2 - 3 muaj
Traf. i femr. 30.04.2010	Vend. Nr. 29 01.06.2010	1 - 114/b3	Kalim te akteve Prokurorisë	Lënie në fuqi e Vend. të Shk. I	2 - 3 muaj
Traf. i femr. 18.05.2010	Vend. Nr. 36 29.06.2010	1 - 114/b1	11 vjet + 4 mil. L gj.	Mospranim ankimi	2 - 3 muaj
Traf. i femr. 01.06.2010	Vend. Nr. 55 26.10.2010 (Ndrysh. i cil. jur per 2 pers 109/a-25	4 - 114/b1	10 vjet 10 vjet 10 vjet 10 vjet	10 vjet 10 vjet 5 vjet -109/a25 5 vjet -109/a25	4 - 5 muaj
Traf. i femr. 24.11.2010	Në gjykim	1 - 114/b1	8 vjet + 3 mil. L gj.	Në gjykim	-
Traf. i femr. 25.11.2010	Në gjykim	1 - 114/b1	11 vjet + 3 mil. L gj.	Në gjykim	-
Total: 9		14	7 – 15 vjet burgim 3 – 6 milion L. gjobë		2-5 muaj

ANEKS IV – Fëmijë të dëmtuar nga krime dhe veprimtari të tjera të paligjshme gjatë vitit 2010

Nr.	STRUKTURAT DHE VEPRA PENALE SIPAS TENDENCAVE	MOSHA
		Deri 18 vjeç
<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>
I	Strukturat Kundër Krimeve të Rënda	119
1	<i>Krime kundër jetës</i>	65
a	Vrasje	18
b	Vrasje nga pakujdesia	6
c	Vrasje e mbetur në tentativë	41
2	<i>Krime kundër shëndetit</i>	52
3	<i>Krime kundër lirisë së personit</i>	2
II	Strukturat Kundër Trafiqeve të Paligjshme	27
1	Trafikimi i personave	0
2	Trafikimi i femrave	0
3	Trafikimi i të miturve	1
4	Trafikimi i mjeteve motorike	0
5	Trafikimi i armëve dhe municioneve	0
6	Të tjera	6
7	Prostitucioni	20
III	Strukturat e Hetimit & Parandalimit të Krimeve	315
1	Krime seksuale	45
2	Kanosja serioze për hakmarrje ose gjakmarrje	0
3	Kanosja	43
4	Plagosje e lehtë me dashje	104
5	Të tjera nga Hetimi dhe Parandalimi	62
6	Të tjera nga jeta dhe shëndeti	61
IV	Strukturat e Qarkullimit Rrugor	118
1	Fëmijë të dëmtuar si pasojë e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor	118
V	Dhuna në familje	
1	Fëmijë të dëmtuar nga dhuna në familje	120
-	SHUMA	699